





# 20 vite së bashku në rrugëtimin e thesareve Dukagjinase

Me datën 9 Qershor 2023 në ambientet e fshatit të Paqes, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", që në orët e para të mëngjesit hapi dyert e festës, duke ju uruar mirëseardhjen vëllezërve dhe motrave nga të gjitha trojet Shqiptare. Shumë prej të pranishmëve morën rrugën ndoshta pa agur ditë e re që ata të ishin nga më të parët në festë dhe kështu ndodhi pasi njëri pas tjetrit u bashkuam dasmorët e kësaj feste nga Peja, Vlora, Ferizaj, Gjilani, Lipjani, Deçani, Istogu, Tirana, Durrësi, Laçi, Lezha dhe Malësia e Madhe.

Përqafime dhe urime të shoqëruara nga fjala sa shpejt ecin vitet. Ecëm së bashku dhe u rritëm së bashku. Një maratonë 20 vjeçare, e cila filloi dhe po vazhdon duke i bashkuar Shqiptarët gjatë rrugës dhe ku sot keni ndalur për të festuar në stacionin e 20 viteve.

Jemi 20 vjeç, në lulen e rinisë edhe pse disa nga themeluesit e mbartin mbi vete thinjat e kohës, por me shpirtin e tyre të ri, dinë të dhuroj urti e dashuri. Plot 20 vite të shoqëruara me plot punë dhe përkushtim do e kurorëzonin Dukagjini me titullin "Nderi i Kombit". Mision i realizuar më së miri, por e mira s' ka fund dhe ky mision do vijoj të dhuroj mirësi në shërbim të Dukagjinit dhe Kombit.

Në hyrje të Teatrit, Genti Boka me disa të rinjë vendosin në gjoksin e të pranishmëve simbolin e festës dhe shpjegojnë edhe vetratën e mbushur më vegla muzikore dhe mjete punë të mjeshtrit duar Artë, Gjek Tom Boka. Genti i solli nga Lezhë për ti shtuar festës edhe një thesar, të cilin ja la babi i tij. Ai sot i solli duke i vendosur mbi Flamurin Kombëtarë në këtë ditë të shënuar, ku shumë prej të pranishmëve e kujtuan Gjekën me respekt dhe mirënjohje të thelle.

Pas mirëseardhjes, në Teatrin e Fshatit të Paqes filloi koncerti festive ku jehona e këngës majëkrahut na solli freskinë e bjeshkëve, të cilat dielli i ledhaton duke ju dhanë jetën që bashkohet përgjatë historisë me lavdinë që bijtë dhe bijat e kësaj trevë e gdhendën me dashuri e sakrificë. Dukagjini në mes këtyre bjeshkëve mori emër që të mos shuhet kurrë.

Sipas traditës së festave dukagjinase kjo këngë u interpretua nga Gegë Zefi dhe Gjon Kosteri. Tradita vazhdon pas të zotëve të shtëpisë nga Rugova e mbush ambientin, melodija dhe interpretimi i valles tradicionale ku valltari Florim Nikçi sjell motivet e rrugëtimin kreshnik të shqiptarit në histori.

Mirëseardhja e dytë për të pranishmit dhe prezantimin e tyre e sollën dy moderatorët Klodiana Serraj dhe Vjola Shqau (anëtare të Kryesisë së Shoqatës).

Na nderoj me pjesëmarrjen e tij, Shkëlqesia e tij, Imzot Angelo Massafro, Kryetari i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë,

Nënkryetari i Bashkisë z. Tonin Deda, I deleguari i Bashkisë Shkodër, z. Luan Harusha, Deputet dhe ish kryetar i komu-



nës Rrethina dashamirës i Dukagjinit, Administratori i Njësisë administrative të Shalës z. Petrit Arra, Administratori i Njësisë administrative të Pultit z. Tom Marku, Përfaqësues te Shoqatës "Martin Dreshaj", me qendër në Peja, me kryetarin e saj, z. Ukshin Jashari, Kryetari i Lëvizjes për Shqipërinë e

Bashkuar, z. Frashër Racaj, Përfaqësues të ansambllit "Rugova", me nënkryetarin e saj, z. Florim Nikçi, Përfaqësues të Teatrit "Aleksandëri Moisiu", në Peje, me drejtorin e tij, z. Fadil Grabovci, Përfaqësues të shoqatës "Nikaj Merturi" me kryetari e saj, z. Gjin Progni, Përfaqësues të shoqatës "Mirëdita",

dega Shkodër, Mjeshtri i Madh Zef Gjini,

Kryetari i shoqatës "Malësia-Nderi i Kombit", z. Sytqi Ndreca,

Kryetari i shoqatës "Bytyçi". z. Agron Ida Gjedia,

Grupi folklorik i Gjilanit, me në krye Xhemajl Berisha,

Krijues dhe veprimtari i çështjeve kombëtare Sefer Tasholli nga Lipjani,

Këngëtari nga Klina, z. Fatmir Berisha,

Këngëtari nga Istogu, z. Ismet Demaj,

Anëtarë të lidhjes së shkrimtarëve për Shqipërinë e Veriut, Agron Prebibaj, Farida Zmijani Ramadani, Mimoza Rexhvelaj, Bora Mulaj Llukaj e të tjerë,

Përfaqësues të ansambllit "Treva", me në krye kantautorin Fran Kodra,

Përfaqësues të ansambllit "Besa", me në krye kantautorin Ndoc Fusha, të cilët e





vijuan festën, me një këngë, e cila i kush-tohej jetës 20 vjeçare të Shoqatës, e cila u pasua me interpretimi të këngëve dhe valleve të tjera, të cilat shoqëruan edhe ndarjen e titujve të nderit, të cilët me rastin e 20 vjetorit kryesia e Shoqatës kishte vendosur të nderonte shumë figura historike, të artit, të arsimit, veprimtarë dhe bashkëpunëtorë të SHAD.

Kryetari Shoqatës z. Ndue Sanaj për të pranishmit në fjalën e rastit solli veprimtari 20 vjeçare të SHAD

Një falënderim i përzemërt për ata që nga ana financiare mundësuar realizimin e kësaj feste, Enjell Radohima, Viktor Arrinaj, Kole Sukullari, Edmond Tërthorja, Fran Shytini, Elzarit Mark Pjetri, Motër Dukate Radoja, Gjon Dukgilaj e Rajmonda Sula, Kole Çardaku, Prele Kroj, Anton Kosteri e Prele Milani.

**Me titullin “Mirënjohja Mësuese Kushë Micja” u nderuan:**

1-Jason Pjeter Rushaj, nxënës, pas vdekjes,

2-Fran Lisi nga Shllaku, mësues në pensioni,

3-Xhahid Bushati, mësues në Breg Lumi Shalë, shkrimtar e pensionist,

4-Kolë Gjoka nga Lotajt, mësues në pension,

5-Zija Vukaj, mësues në fshatin Ndreaj e Palaj në krahinën e Shoshit, shkrimtar, përkthyes e publicist,

6-Ndoc Zef Prendushi, nga Shllaku, mësues në pensioni,

7- Mark Gjoni, mësues në pension, nga Lotajt,

8-Emanuel Petrit Suka, rapsodi më i ri i Dukagjinit, nga Thethi.

**Me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, u nderuan:**

1-Mark Lula- Vladaj, i krahinës së Shalës, pas vdekjes, pjesëtar në Lidhjen e Prizrenit.

2- Gjekë Gega i krahinës së Shllakut, pas vdekjes, pjesëtar në Lidhjen e Prizrenit,

3- Marash Kola i krahinës së Shoshit, pas vdekjes, pjesëtar në Lidhjen e Prizrenit,

4- Gjekë Tomë Boka, Mjeshtri duar artë, pas vdekjes,

5- Mjeshtri i Madh-Kantautori Rrok Gjellaj, kryetari i shoqatës “Bilbilat”,

6- Frashër Racaj (Sekretari i shoqatës “Martin Dreshaj” dhe Kryetari i Lëvizjes për Shqipërinë e Bashkuar,

7-Gjergj Mark Suka, rapsod (lahutar), pas vdekjes,

8- Gjergj Ndreka Luca, artist dhe biznesmen i suksesshëm,

9- Gjon Marashi, luftëtar për liri, për çlirim kombëtar,

10- Bale Mark Milani, veprimtari dhe luftëtar për çlirim kombëtar,

11- Kole Nosh Arrinaj, deputet e kryetar i lokalitetit të Dukagjinit.

12- Zef Gjellosh Arra, deputet e kryetar kooperative.

**Me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini” u nderuan:**

1-Gjon Kosteri, anëtar i SHAD, veprimtar dhe rapsod,

2-Roza Pjetri, anëtare e kryesisë së SHAD, veprimtare dhe gazetare,

3-Luigj Mila, anëtar i SHAD, Sekretar i Komisionit për Drejtësi e Paqe,

4-Mark Dreni, veprimtar me banim në Nju-Jork,



5- Prele Milani, N/kryetari i SHAD, studiues, poet e publicist,

6- Suela Ndoja, anëtare e kryesisë së SHAD, Kryeredaktore e gazetës “Dukagjini”.

Përfaqësues të Shoqatës “Martin Dreshaj”, me qendër në Peja, me kryetarin e

saj, z. Ukshin Jashari; Kryetari i Lëvizjes për Shqipërinë e Bashkuar, z. Frasher Racaj; Përfaqësues të ansambllit “Rugova”, me në krye kryetarin e saj, z. Vasel Nikçi dhe Përfaqësues të Teatrit “Aleksandëri Moisiu”, në Pejë, me drejtorin e tij, z. Fadil Grabovci; dhuruan për shoqatën Atdhetare “Dukagjini” dhe anëtarët e saj

disa tituj nderi, për Ndue Sanaj, Roza, Pjetri, Dukate Bregu, dhe Prel Milani.

Pas ndarjes së këtyre titujve koncerti do mbajet me vallen e interpretuar nga valltarët e talentuar të shkollës 9 vjeçare “Ded Gjon Luli” të përgatitur me mjeshtri nga mësuesja Drita Zefi. Me këtë rast gjejmë rastin të falënderojmë edhe mësueset e kësaj shkolle që mundësuan praninë e këtij grupi.

Falënderojmë që koncertin krahas të lartpërmendurve ja rriten vlerat me emocionet që përcollën me interpretimet e tyre, Fatmir Berisha, Ismet Demaj, Xhemajl Berisha, Fran Kodra, Ndue Shytani, Sokol Bjoni, Vjola Shqau dhe shumë i talentuari dhe e ardhmja e lahutës së Du-



kagjinit- Emanuel Petrit Suka, nga Thethi.

Falënderime të pafundme për të gjithë nga dy moderatorët, të cilat i ftuan të pranishmit që të merrnin pjesë në paraqitjen më veshjet tradicionale. Në skenën natyre që Zoti ja ka dhuruar Shkodrës në Fshatin e Paqes. Tri gjenerata të gërshetuarara shumë bukur përcollën emocionet e radhës të shoqëruar nga vlera e këtyre veshjeve.

Pas paraqitjes së veshjeve tradicionale vine momente të ëmbla të fotove ku të gjithë realizuan dëshirat e tyre të merrnin nga kjo dite krahas kujtimeve të tjera edhe fotot dhe vidiot në mesin e ngjyrave të këtyre veshjeve dhe dëlirësisë e dashamirësisë së atyre që i mbanin veshur.

Për realizimin e kësaj paraqitje ideuan dhe punuan që të realizohet Roza Pjetri, Dukate Bregu, File Strugaçi, Gjon Dukgijaj, Rajmoinda Sula, Drita Zefi, Ndoc Fusha dhe Gjyste Çarku Bici

Tradita vijon me koktejin, në të cilin u bashkuan me nga një gotë me të gjithë të pranishmit të shoqëruar edhe me ndarjen e titujve nderi,

**“Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini” u nderuan:**

1-Imet Dema, këngëtar, nga komuna e Istogut,

2-Fatmir Berisha, këngëtar nga komuna Klinë,

3-Xhemajl Berisha, këngëtar nga komuna e Gjilanit,

4-Florim Nikçi, valltar i ansambllit “Rugova”, nga Peja,

5--Fadil Grabovci, aktor dhe Drejtori i teatrit “Aleksandër Moisiu”, në Peja,

6- Besim Zabelaj, këngëtar e aktor i teatrit “Aleksandër Moisiu”,

7- Motër Dukate Radoja, me origjine nga Gimajt,

8- Tonin Deda, N/Kryetari i Bashkisë Shkodër,

9-Diana Bungu, veprimtare,

10-Mhill Shkami, intelektual e biznesmen i suksesshëm,

11-Mark Rupa, intelektual e veprimtar me kontribute të rëndësishme,

12-Nikolin Shqau, biznesmen i suksesshëm,

13-Preke Gjonaj, veprimtar, me banim në Kanada,

14-Sokol Sterbyqi, veprimtar, me banim në Kanada,

15-Marjana Koçeku, Malësorja e re, veprimtare,

16-Gëzim Çardaku, veprimtar, me banim në Zvicër,

17- Petrit Sokoli, veprimtar, me banim në SHBA,

18- Lazer Kulla, veprimtar, me banim në Kanada,

19- Ndoc Fushën, kryetari i Shoqatës kulturore “Besa-Shoshi”,

20-Gjin Niklekaj, kryetari i pare i Shoqatës “Nikaj-Merturi”.

Për të gjithë miqtë e ardhur nga trojet Shqiptare dhe bashkëpunëtorë ndër vite u shtrua dreka, e cila u hap me fjalën dhe bekimin e bukës që dhuroj Imzot Angelo Massafro, e cila vijoi me përshëndetje, urime, falënderime dhe këngë.

Duan të falënderojmë edhe grupin e punës të Fshatit të Paqes, i drejtuar nga Dedë Mirashi, i cili gjithmonë bashkëpunon me përkujdesje, që festat dhe veprimtaritë e SHAD të realizohen sa më mirë.



Një falënderim edhe për mediat, të cilat e përcollën atmosferën e kësaj feste edhe për të gjithë shikuesit anë e mbanë botës. Faleminderit TV1Chennel, TV Kopliku, TV Fontana, me në krye Zeqir Mehmetaj e të tjerë.

Falënderojmë përzemërsisht të gjithë të pranishmit që në rrjetet e tyre sociale e përcollën emocionet e kësaj feste.

Falënderim dhe mirënjohje anëtarët e SHAD, për kontributin e tyre të pakursyer

në realizimin e misionit të Shoqatës, që kanë ndërruar jetë.

Falënderim dhe mirënjohje për të gjithë anëtarët e Shoqatës, që për arsye shëndetësore dhe emigrimi sot na munguar fizikisht, por jo më zemër. Në veçanti duke i uruar shëndet të mirë dhe rikthim të shpejtë, Sekretarit dhe kryeredaktorit të gazetës “Dukagjini” z. Luigj Shyti.

E ndjejmë për detyrë të falënderojmë në përfundim të kësaj kronike grupin e

punës, që u morën me ideimin dhe realizimin e kësaj feste: Ndue Sanaj, Kolë Sukudhari, Agron Hasani. Gjergj Leqejza, Kolë Çardaku, Roza Pjetri, Dukate Bregu, Vjola Shqau, Klodian Serraj, File Strugaçi dhe Drita Zefi.

Falënderojmë të gjithë themeluesit e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe të gjithë ata që kontribuan dhe i dhuruan 20 vite jetë kësaj shoqate, e cila vijon të mbetet dritare e hapur, që lejon rrezet e diellit dhe flladin e bjeshkëve ti japin lavdi historisë së Dukagjinit dhe bijve të saj.

Kjo histori po shkruhet çdo ditë mirë dhe bukur. Kjo festë dëshmoj edhe një herë se Thesaret Dukagjinase, që nuk vdesin nëntokë, por marrin jetë dhe shumëfishohen duke ecur së bashku në kohë dhe breza.

Faleminderit!

Roza Pjetri





# Fjala prezantuese e punës 20 vjeçare e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”

E ndjeje veten mirë, që jam para jush, me rastin e këtij 20 vjetori!

U bën 20 vjet punë e vetëm punë, punë e pa ndalur e shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në themel të cilës ka pas vetëm dhe vetëm një çelës, i cili për shumë kënd është dukur i pabesueshëm, por ky çelës ka qene “vullnetarizmi!” Prandaj, vijmë në këtë njëzetë vjetor, vijmë para jush, para dukagjinave, para qytetarëve shkodranë, para miqve dhe bashkëpunëtorëve kolege, krenar për punën që kemi bërë.

Në këtë feste marrin pjesë anëtar të shoqatës, Anëtar Nderi të saj, përfaqësues të shoqatave e organizatave bashkëpunues që nga Republika e Malit të Zi, në Republikën e Kosovës dhe deri në Kosovën Lindore, të famullisë Shkodër, të ushtarakeve në rezerve dhe në pension, të veteraneve, përfaqësues të pushtetit vendor të qytetit Shkodër dhe të Njësisë Administrative të Dukagjinit, shkrimtare, poete, studiues, përfaqësues të mediave lokale, të tjerë e të tjerë, të cilëve, në emër të Kryesisë, ju uroj mirëseardhjen, për të na nderuar në këtë feste të shoqatës, e cila nuk është feste vetëm e jona, por është festë edhe e Dukagjinit, edhe e qytetit tonë.

Njëzetë vjet më pare, grupi i përberë nga Ndue Sanaj, Prele Shytani, Luigj Shyti, Mri Kroj, Ndue Vata, Pal Lera, Fran Kapaj, Fran Preçi, Martin Ara dhe Zef Nika, mori nismën të themelojnë një organizatë të bashkëpunimit dukagjinave, duke pasur në vëmendje të punës së tyre moton: “Mos pyet se çfarë bëri Dukagjini për ty, por çfarë unë bëra dhe do të bëj për Dukagjinin!”

Misioni i Shoqatës ishte i thjeshtë: “Duke u mbështetur në historikun e së kaluarës dhe të sotmes, duke respektuar ndjenjat dhe sakrificat e të parëve për liri e pavarësi, Dukagjini të zërë më mire vendin që meriton në hapësirën e qytetëruar dhe moderne”, i cili në konferencën e VI të saj, mbajtur në muajin tetor 2018 u pa e nevojshme të ndryshojë: dhe të jetë: “Puna dhe përpjekjet që duhen bërë, krahas vijimit të njohjes së mëtejshme e promovimit të vlerave të zonës së Dukagjinit, për emancipimin shoqëror të dukagjinave kudo janë, me objektivin që si qytetar të mirë e në bashkëpunim me njeri - tjetrin, të ecim përpara drejtë standardeve evropiane”.

Me datën 13 maj 2003, me vendim nr. 666, të Rrethit Gjyqësor të Tiranës, shkal-la e pare. Me datën 7 qershor të atij viti, në sallën e Prefekturës të asaj kohe, beri prezantimin e themelimit të saj.

E filluam shoqatën me 32 anëtar dhe sot jemi 270 anëtar të shoqatës, që janë shtrire në 5 dege, në Tiranë, në Kurbin, në Lezhe, në Shkodër dhe në Malësi të Madhe, pavarësisht punës së tyre të vijueshme.

Në gjirin e saj ka “Anëtar Nderi”, nga të gjitha fushat, përfshi historianin Romeo Gurakuqi, përkthyesin e shkrimtarin Meritan Spahia, politikanin e luftëtarin Ramush Harajdinaj e luftëtarin e shkrimtarin Flora Borovina, të Madhin Shtjefen

Ivezaj, Rita Shkurtaç, kryetaren e shoqatës kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare” dhe deri te Ukshin Jashari, kryetari i Shoqatës së Vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” me qendër në Pejë e të tjerë.

Gjate këtyre viteve, me keqardhje ju njoftoj se, janë nda nga jeta disa anëtar shoqate: anëtarët e shoqatës Karlo Marlekaj, Karlo Kamsi, Marash Ndoja, Ndue Dede Bregu, Martin Çuni, Nik Pali, Nikoll Vocaj, Marash Kola, Zef Fusha, Ndoc Grimaj e Mark Lumaj, dhe Anëtar i Nderit, Artisti i Popullit Lec Shllaku, Mjeshtri i Madh Fadil Kraja, profesori Ahmet Osja, Mjeshtrin Ndoc Gurashi, Prenda Shpendi, Tome Shpendi, Profesor Gjergj Perluca, profesor dr. Mahir Hoi dhe të tjerë...

Më lejoni, që në respekt të jetës e veprës së tyre, t’iu ftoj të ngrihem në këmbë dhe të mbajmë një minute heshtje! ....

I përjetshëm qoftë e kujtimi i tyre!

Më lejoni të bëj një paraqitje të shkurtër të arritjeve në funksion të realizimit të misionit të shoqatës në këto 20 vite:

Njëzetë vjet hulumtime e studime, botime dhe publikime për vlerat dukagjinase, të cilat kane qene pjese e jetës së tyre në shekuj në shërbim të vetëqeverisjes, të atdhetarizmit, të përkushtimit për të qene të lire e të pavarur në jetën e tyre, të cilat janë kurorëzuar me 9 simpoziume shkencore, me teme: “Kuvendet malësore dhe koha” kushtuar 85 vjetorit të Besës së Prekalit; me teme “Traditat atdhetare dhe lirishtetësi të dukagjinave në vitet 1890-1920” kushtuar 95 vjetorit të Luftës së Qafës së Agrit dhe 90 vjetorit të Luftës së Planit; “Një misionar në shërbim të Kombit”, kushtuar 100 vjetorit të lindjes të një prej figurave të rëndësishme të nacionalitetit shqiptar, At’ Jak Marlekaj, ose profesor Luigj Marlekaj; me temë “Kultura materiale e shpirtërore e dukagjinave”; me teme “Femra dukagjinase në kohe”; me teme “Gjakmarrja retorike apo realitet”, në bashkëpunim me Komisionin Drejtësi e Paqe, kushtuar kësaj gjendje të rende të vrasjes nder veti të shqiptareve dhe shfrytëzimi i saj nga disa antishqiptar për të përfituar; një konference përkujtimore, me teme: “Ndihmesa e kryengritjeve Antiosmane të malësoreve të Veriut për arritjen e Pavarësisë”, në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, në bashkëpunim me shoqatën “Martin Dreshaj” dhe “Integrimi Evropian”; një seminar shkencore, me teme “Drejtimit e mundshme të zhvillimit të Dukagjinit”, në kuadrin e përpjekjeve për zhvillimin e zonës dhe të banoreve të saj, dhe Konferenca shkencore, me temë “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin”, me 14 tetor 2017.

Menduam që në punën tone të kemi një avokat!? Avokatin e gjetëm, madje nga më të mirët, gazetën, e cila është e pagëzuar me emrin “Dukagjini”, numrin e pare i së cilës u paraqit në media televizive dhe në publik me datën 30 dhjetor 2003. Atë e kemi prezantuar çdo muaj. Me 31 dhjetor

2022, festuam njëzetë vjetorin e nxjerrjes së numrit të pare të saj dhe në këtë muaj do të dali nr. 236 i saj. Për nxjerrjen e kësaj gazete nuk ka qene e lehte, por gjithsesi kane investuar mendimin e tyre 601 autor, me 3 425 artikuj nga një artikull dhe deri në 259 artikull, që është zoti Prele Milani.

Kjo gazete nuk mund të dilte pa mundësimin financiar të saj. Deri tani kanë mundësuar 99 persona, me 5 059 742 leke, nga 2 000 leke dhe deri 1 550 000 leke, që është zoti Gjergj Leqejza, duke financuar 57 numra gazete dhe Ndue Ftoni me 913 300 leke, duke financuar 43 numra gazete.

Kemi bërë përpjekje të nxisim hulumtuesit, studiuesit e shkrimtarët të shkruajnë, dhe diçka ia kemi arrite qëllimit. Shumë dukagjinave kane shkruar, shumë dukagjinave kane botuar. Një pjese prej tyre ia kemi prezantuar publikut. Deri tani janë paraqite 79 libra të autoreve dukagjinave, që kane shkruar kryesisht dukagjinave për Dukagjinin. Ata janë të shumtë, por kryesisht janë Ndue Cukeli, Prele Milani e Lazer Kodra, Ndoc Bjeshka, Shefqet Kelmendi, shkrimtari Lazer Stani, Mirash Mici, Artisti i Popullit Lec Shllaku, Voc Deda, prof. as. dr. Zef Gjeta, Lulash Brigja, Sokol Prela, Mjeshtri Fadil Kraja, Luigj Shyti, Mhill Pali, Pal Doçi e të tjerë, të cilëve ju themi: “Të mos ndalen, të vijojnë, të vijojnë e të vijojnë të shkruajnë se, ajo që hidhet në letër mbetet, të tjerat i merr era dhe mbesin në nivelin e legjendës, të cilat këto janë të bukura, por jo në pak raste po na lodhin”.

Kemi bërë përpjekje që nëpërmjet veprimtarive artistike të mbledhim e të publikojmë vlerat folklorike dukagjinase. Kemi realizuar 10 mbrëmje argëtuese; është dhanë një koncert folklorik, të pagëzuar “Folk-2007” në Teatrin “Migjeni” dhe janë mbështetë edhe tre koncerte të tjera, çka ka dhënë mundësinë të prezantohet sa më denjësisht në mjedisin shkodranë folklori dukagjinave nëpërmjet interpretimit të këngëtareve dukagjinave, të cilët tashmë janë të organizuar në ansamblin “Trevë” e Dukagjinit.

Kemi bërë përpjekje që nëpërmjet ekspozitave, si ekspozita e fotografisë nga Luigj Shyti dhe Luigj Mila dhe ekspozita e pikturës të pagëzuar “Peneli dukagjinave” me 18 piktore të moshave të ndryshme, me në krye Artistin e Merituar Zef Shoshi dhe Mjeshtrin Ndoc Gurashi, duke publikuar natyrën e bukur të hapësirës së Dukagjinit dhe vlerat artistike të dukagjinave në fushën e fotografisë dhe të pikturës.

Kemi bërë përpjekje të mos mbesim në vetvete, të jemi të hapur. Kemi bërë përpjekje të jemi prezent ku ka qene e mundur. Sot jemi anëtar themelues të organizatës së mediave lokale “Klubi Shqiptar i Medias”; në organizatën Grupi i Veprimtari Lokal “Bjeshkët me Name” të ndihmuar nga djali i Thethit Mark Rupa; me organizatën e Gruas “Hapat e Lehte”, me Universitetin “Luigj Gurakuqi”; me bibliotekën e

qytetit “Marin Barleti”, me Muzeun Historik në Shkodër, me Teatrin “Migjeni” e me teatrin “Iliricum”, me Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë, me Këshillin e bashkisë së qytetit tonë; me Komisionin Drejtësi e Paqe me qendër në Shkodër; me organizatat: “Ambasadoret e Paqes”. Në veçanti, bashkëpunimi më i suksesshëm ka qene lidhja me Shoqatën e Vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” me qendër në Pejë. Me gjithë këtë bashkëpunim, jo vetëm na është krijuar mundësia të prezantohemi, por na është dhanë mundësia të shkëmbejmë eksperiencë në të mirë të ecjes përpara për të realizuar misionin e shoqatës, e cila do të vijoje edhe në të ardhmen. Me Ansamblin “Rugova” me qendër në Pejë; me Muzeun “Ivezaj” në Lekaj te Tuzit; Manifestimi kulturore “Ora e Maleve”, në Rrozhaj, me Ali Daci në krye; Shoqatën kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”; me shoqatën “Nikaj Merturi”, shoqatën “Bytyçi”, e të tjera e të tjera.

Respekt dhe mirënjohje për punën që bëjnë dhe për ndihmën që na kanë dhanë!

Pra, gjithsejte janë zhvilluar rreth 220 veprimtari, mesatarisht rreth 10-11 veprimtari të ndryshme në vit.

Me punën e bërë dhe me ndihmën e strukturave të pushtetit vendor në Shkodër, të Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe të Presidencës, në këto 20 vjet kemi arrite të kemi në gjirin tone:

\* Atdhetarin Mehmet (Sokol) Shpendi i dekoruar me “Medaljen e Artë të Shqiponjës” dhe urdhrin “Nderi i Kombit”;

\* Profesor Kole Prela “Qytetar Nderi” të qytetit Shkodër dhe urdhrin “Nderi i Kombit”

\* Artistin e Popullit Pjeter Gjoka “Qytetar Nderi” i qytetit Shkodër,

\* Pikturin Lin Delija, me urdhrin “Nderi i Kombit”;

\* Albanologun Martin Camajt, me urdhrin “Nderi i Kombit” dhe “Qytetar Nderi” i qytetit Shkodër,

\* Poetin e madh Frederik Rreshpja, me titullin “Mjeshër i Madh”,

\* Këngëtarja e aktorja Rita Ndoci, me titullin “Mjeshër e Madhe”,

\* Monsinjor Angelo Massafra, me urdhrin “Nënë Tereza”,

\* Dom Preke Ndrevashaj, me titullin “Kalorësi Gjergj Kastrioti”,

\* Gac Çuni “Qytetar Nderi” i qytetit Shkodër,

\* Legjendën e futbollit, Dode Tahiri “Mirënjohja” e qytetit Shkodër;

\* Ndue Sanaj, është nderuar me titullin “Mirënjohja e qytetit Shkodër”;

\* Gjergj Leqejza e Luigj Mila janë nderuar me titullin “Krenaria e Qarkut Shkodër”.

\* Në qytetin e Shkodrës, janë ngritur e vendosur dy monumente, i atdhetarit Mehmet Shpendi dhe albanologut Martin Camaj

Për këtë arritje, të nderimit të këtyre figurave e personalitete Dukagjinave falënderojmë Bashkinë

# Dora e ngrrohtë e Dukagjini!

20 vite histori dhe mirësi Shoqata Atdhetare “Dukagjini”!



Shoqata Atdhetare “Dukagjini” i 20 motesh sa një vashë hirplote një kryefjalë suksesi e shkruar në pergamenë në mënyrë shumë korrekte. Krejt e ndryshme nga tufa larushane e shoqatave grepujë, Shoqata e Dukagjini ka falë me te dyja duart, dashuri, dije, kulture dhe mirësi për atlashin e vet të shtrenjtë.

Shoqata dhe gazeta me të njëjtin emër janë shenjza më e rëndësishme kulturore në historinë e moçme dhe të re të Dukagjinit. Shoqata Atdhetare “Dukagjini” nuk synonte të behej një konglomerat rrumpallë për të treguar muskuj pa ide apo parime të tjera veç devizës “Dukagjin dashnia eme”. Në shoqatën Atdhetare “Dukagjini” u vetëafruan intelektualët idealist jo për të recituar citate dashurie, as kënduar rapsodi heroike për të kaluarën tone homerike, por vullnetarë që dashurinë për vendin e vet do ta tregonin me punë jo vetëm me fjalë të bukura. Qe besa sot, pas 20 vitesh kjo shoqatë ka aq shumëçka për të treguar sa duhen fashikuj për t’i renditur. Por e thënë shkurt e sak: “Dada” ja ka zbardhur faqen vetës, Dukagjinit dhe kulturës së tij të kultivuar. Kush nuk e sheh dhe nuk e ka konstatua këtë fakt nuk është as më shumë e as më pak veçse një cinik i verbuar.

Shoqata 20 vjeçe “Dukagjini”, në këtë maratonë të gjatë me pengesa, pati e do të ketë bashkudhëtarë dhe bashkëpunëtorë

dukagjinasi dhe dukagjinaset më të mirë të gjeneratave të sotme, për gjeneratat historike që pushojnë në dritën e amshuar. Kurrfarë problemi nuk ka pas për ne bindja politike e as një anëtarë që më parë e më shumë donin Dukagjinin se partinë! Kurrfarë problemi nuk ka pas përkatësia, krahinore nga vjen e as një anëtarë që do më shumë Dukagjini se egon fisnore të krahinës së tij. Kurrfarë e keqeje nuk i ka ardhur Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” nga mos drejtimi i saj sipas rendit hierarki otomanist (ish bajraqeve), përkundrazi kjo ka qenë një nga pikat tona më të forta të stabilitetit dhe kohezionit pa grindje, individualizma dhe egoizma inatçare.

Te ne ka liri të plote të menduarit, të shprehur e pjesëmarrje në vendim marrje. Po more, ka pas mendime ndryshe edhe debate të nxehta, por pa kaluar kurrë në përplasje ofendime ose mos bindje individuale. Kurrë nuk ka funksionuar prepotenca -Ulu ti se nuk din gjë. A din ti se kush jam unë e të tjera e të tjera. E çuditshme, por e vërtetë.

Puna dhe kontributi human i shoqatës sonë edhe mosbesuesit më të thekur të saj i bindi të ndryshojnë mendim. Edhe dashakëqijtë që nuk e doni më se urthi



dritën i zbuti duke i nxjerrë të penduar nga llogari i armiqësisë. Shoqata Atdhetare “Dukagjini” ka jo pak kundërshtarë, por nuk ka armiq, kjo tregon shëndetin dhe vitalitetin e saj.

Krijuesit, poetet, publicistët e shkrim-

taret dukagjinasi kanë shkruar e po shkruajnë një faqe të re në historinë e kulturës sonë bashkëkohore. Mirënjohje dhe respekt pa kufi lexuesëve tanë! Ndjesë nëse edhe ju kemi zhgënjyer në shkrimet tona, por nuk ja vlen të humbasim as një sekondë kohë më ata, për të cilët ka më rëndësi një putir raki se gazeta “Dukagjini”.

Nuk ja vlen të shqetësohemi hiç as me ata “kritik” kafeneshë, që nuk kanë lexuar kurrë një libër në jetën e tyre veç më shumë jo se po veç teksteve të detyruar shkollorë. Ka ende disa Donkishot që na quajnë shoqate komuniste. Nga ky kor tifofozësh, ka nga ata që janë njerëz të mirë, familjarë të mire e me katandi, por që për Dukagjini nuk kanë bërë as një gjë, veç paralajmërimit “gjenial”: “Dukagjin ruaju nga rreziku komunist i shoqatës Atdhetare “Dukagjini”! -Ju lumtë vazhdoni t’i bini fyellit në një vrimë! Melodia juaj vajtuese na ka vlejtur shumë të mos vetëkënaqemi dhe të punojmë më fort.

Hakmarrja e vetme jonë ndaj jush është vetëm përmirësimi ynë në çdo hap të punës sonë, për të realizuar misionin tone, misionin e Shoqatës. Ju “martir” të gjallë të luftës më gogolin po ua them troç nëse

nuk e dini: Se qysh se u përmbys Rendi i Bashkësisë Primitive me lindjen e pa barazisë klasore, komunizmi vdiq. U përpoq Jezu Krishti të sillte një botë të drejtë e të barabarte dhe e varën në Kryq. As një komunist tjetër mbi dhe nuk ka pasur kurrë

më. Unë do doja një Botë ideale komuniste pa klasa e luftë, pa dhunë e pabarazi shoqërore dhe me mirëqenie të përbotshme. Ju lutem mos na bëni një nderë kaq të madh sa dhe të pa arritshëm. Një nga bekimet tona më të shenjta ka qenë mos bërija vegël politike e askujt. Nuk jemi të gabueshëm, por jemi e do jemi gjithmonë dora e ngrrohtë e Dukagjinit. As një parti sot, as pari kah mot nuk kanë bërë për Dukagjinin sa kjo shoqatë tash 20 vjet. As një deputet për veç historikut Profesor Kole Prela nuk ka bërë për Dukagjinin sa Kryetari i kësaj shoqate Ndue Sanaj. Ky është një fakt dhe jo sentiment i thënë nga një njeri që i ka me pikatore autolëvdatat dhe për këtë jam në gjendje të debatoj me këdo që nuk mendon kështu.

Një here me tha një mik, çfarë keni bërë për të varfrit?! Ne, nuk jemi shoqatë që shpërndajmë rroba, as makarona, misioni ynë është të luftojmë dhemb për dhemb varfërinë shpirtërore, që është ulur këmbëkryq, sidomos në zemrat e barkfryrëve. Ne jemi përpjekur të kultivojmë dashuri për librin, kulturën, për njeri-tjetrin, për njerëzit që mendojnë ndrysh nga ne dhe për të tjerët që besojnë ndryshe. Detyra jonë është të edukojmë rritjen përgjegjshmërisë në vlerësimin dhe nderimin e historisë dhe atdhetarisë se vërtetë.

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, është e do të mbetet shqyt e pa thyer në luftën kundër çdo diskriminimi që i behet Dukagjinit nga kushdo e sado i fuqishëm e dinak të jetë.

Shoqata Atdhetare “Dukagjini” do vijojë pa kompromis luftën kundër veseve arkaike të së shkuarës dhe shpërftyrimeve të pa përgjegjshme të së sotmes. Arroganca mendjemadhësia fudullëku, egoizmi deri në urrejtje, lufta egër brenda llojit, kokëfortësia, kacafytja me kacaturre, individualizmi, kulti i verbër, politik e fisnor janë armiqtë më pa të pajtueshëm të Dukagjinit dhe çdo bashkësie, familjeje apo individi shqiptar mbartës i tyre.

Shkullofsh Shoqata Atdhetare “Dukagjini” ballë djersitur e mendje ndritur në misionin tënd!

Prele Milani

Shkodër për mbështetjen që na ka dhanë, dhe Institucionin e Presidencës për miratimin e propozimeve përkatëse.

\*\*\*

Të gjitha këto arritje, nuk janë bërë me frymën e shenjtë. Ato kane pasur një kosto jo të pakte financiare. Financimi i veprimtarive të shoqatës është siguruar fale bujarisë të 315 dukagjinaseve, në mes të cilëve më lejoni të veçoj Ndue Ftonin në SHBA, Konsullin e Nderit të Republikës së Austrisë, Gjergj Leqezjen në Shkodër, Komunën e Pultit, biznesmenin Mhill Pr-

ronin, Pal Gjollaj, Gjergj Vocaj, Pal Lera, Kompaninë e sigurime “SIGMA” dega Shkodër, Kolë Çardaku, Prenda Shpendi, Martin Bardhoja, janë dukagjinasi me banim në Nju-Jork, të cilëve kanë kontribuu me 52 500 dollarë; në Miçigan; në Bruksel e në Zvicër; në Kanada; në Shqipëri, e të tjerë e të tjerë, në Itali e Greqi

Të gjithë, në emër të shoqatës i falënderoj për kontributin e tyre, për atdeshdashurinë e tyre ndaj Dukagjinit e dukagjinaseve! Paçin e dhënçin! Por dhe i ftojme të vijojnë e të vijojnë të japin e kontributin e tyre në realizmin e misionit të Shoqatës.

\*\*\*

Me këto arritje nuk kemi bërë ndonjë shpikje shkencore, as nuk kemi hip në ndonjë lartësi që të tjerët nuk kane hipur më pare, por kemi bërë punën tonë modeste, që duhet të bëj çdo atdhetar. Kemi bërë përpjekje që sot ta shikojmë veten nga një gjendje morale tjetër, dhe besojmë se ia kemi arrite qëllimit në nivel të kënaqshëm.

E ndiejmë veten të kënaqur, në qoftë e se sadopak të tjerët do ta shikojnë të mirë ketë që kemi bërë deri tani, dhe mbi bazën e së cilës do të bëjmë edhe në të ardhmen. Në mbyllje, në emrin tuaj, më lejoni

të falënderoj dhe t’iu shpreh mirënjohjen atyre që na bën të mundur financimin, të festojmë sot së bashku: Biznesmeni Viktor Arrinaj, Enjell Radohima, Gjergj Leqezja, Fran Shytani, Edmond Tërthorja, Kole Sukullari, Motër Dukate Radoja, Kole Çardaku, Ezarit Mark Pjetri, Prele Kroj, Anton Kostri...

Gëzuar Festen!

Gëzuar 20 Vjetorin e themelimit të Shoqatës!

Ju faleminderit!

NDUE SANAJ,  
KRYETARI I SHAD



# Shoqata Atdhetare "Dukagjini", po rrnon për me tregue!

## 20 vite jetë për promovimin e Dukagjinit shekullor!

Dukagjini, krenaria e identitetit tonë kombëtar festoi 20 - vjetorin e Shoqatës Atdhetare Dukagjini.

Dje fshati i Paqes në Shkodër u pushtua nga dukagjinasi e miqtë e tyre nga trojet shqiptare, gjithçka nën drejtimin e të zotit të shtëpisë z. Ndue Sanaj (kolonel), moderatores Roza Pjepri e stafit organizativ mikpritës.

Një aktivitet mjaft i larmishëm i ndarë në katër seanca: së pari festa nisi nga salla; aty folën të gjithë duke festuar me këngë e valle nga artistët e Dukagjinit e Kosova, pastaj u zhvendosëm në promovimin e veshjeve tradicionale e veglave muzikore të trevës, ndërsa koktej festiv për të pranishmit solli afrimet e njohje e bashkëpunimi për secilin pjesëmarrës, aty u ndanë edhe disa tituj nderi për disa personalitete me kontribute, por respekti për mysafirët mbyllet sipas traditës dukagjinase me drekën e ngrohtë e mikpritëse, kjo dreka bekuar nga Arqipeshvi Angelo Massafra, i cili uroj paqe e lumturi për shqiptarët.

Tek me erdhi në mend kryevepra e At Zef Pllumi - "Rrno me tregue", një pasim perfekt nga Shoqata Atdhetare Dukagjini, e cila në 20 vite jetë promovon historinë

shekullore të trevës legjendare, me histori qëndrore e fitimtare e cila mbushet më me shumë me dhimbje sesa gëzime, promovuese e kulturës me orientim perëndimor.

Kur lexon e dëgjon historinë e qëndresës e kulturës janë dy medalje të forta identi-



tare, por realisht dukagjinasi megjithëse i vendosur lart në alpe, shtëpitë i kishte kulla guri dy-tre katesh duke parakaluar ata që jetonin në fushë, gjithashtu Dukagjini i artistëve, shkrimtarëve, sportistëve e të tjera zotëron më shumë se 30% të thesarit së qytetërimit shkodran e verior!

Në festimin e 20 vjetorit të Shoqatës Atdhetare Dukagjini erdhën plotë mesazhe ngrohëse, vëllazërore e bashkëpunimi, e nisur që nga fjala rezyme e kryetarit Ndue Sanaj, e përcjellë nga shoqatat kosovare, nën ngrohtësinë e Arqipeshvit Massafra, ndërsa shkrimtari e publicisti Prele Mi-

Ndërsa kryetari i shoqatës Bytyçi, z. Agron Gjedia solli mesazhin miqësor të bashkëpunimit nder shekuj mes Malësisë së Gjakovës e Dukagjinit të pasur me histori.

Por si gjithnjë unë ndihem i ngacmuar nga miqtë e mi Edmond Tërthorja, Agron Hasanaj e Anton Kosteri, ku me shakatë e tyre më bëjnë të gëzohem duke qeshur, por edhe më bëjnë të përdor një paracetamol...!

Ndërsa surpriza erdhi, kur Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" nderoi zotin Gjin Niklekaj, me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", ky nderimi ndaj një personaliteti të madh Nikaj-Mërturas, Dukagjinasi e më gjerë.

Befasia e rendimenti i veprimtarisë së kësaj shoqate vjen kur shikon në tani 20 vite në çdo muaj një promovim, 20 vite gazeta "Dukagjin"i edhe kjo e përmuajshme, ku me plotë gojë mund të thuhet si e shkruar se kjo shoqatë parakalon Ministrinë e Kulturës me veprimtari në këto 32 vite.

O sa mirë me qenë shqiptar nga Dukagjini o hej!

**Agron PREBIBAJ**

## Disa opinione të vecanta

### Bona Mulaj Lluka

Dukagjin o me djep e varre  
Ti në gjunjë jo su ule kurrë  
Besën pate, o ti gjanë ma t' madhe  
Veç për komb, o e për flamur...  
Kush shkoj në ato bjeshkë e nuk u ndje  
më fisnik, më madhështor, më krenar se  
ka lindur në këto troje...?!

Kush trokiti në derë të malësorit e nuk  
gjeti besë, nder e burrëri, e nuk u largua  
me dëshirën për tu kthyer përsëri..

Ajo sallë, sot plot me miq nga Rugova,  
Gjilani, Istogu, Peja, Gjakova, Tropoja,  
Mirdita e mbarë trojet shqipfolëse, dësh-  
moj më së miri se dukagjinasi kanë ditur  
gjithmonë të mbajnë ndezur vatrat që  
mbledhin vllazni.

Gëzuar 20- vjetorin Shoqata Atdhetare  
"Dukagjini"!

Faleminderit që më keni bërë pjese të  
çdo veprimtarie të tuajin e nderuar e res-  
pektuar sa here kamë ardhe nder ju.

Urime e suksese edhe për 100 vite të  
tjera Dukagjini "Nderi i Kombit"!

Mirënjohje!

### Mimoza Rexhvelaj

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" sot  
mbushi 20 vjeç, bash në lule të rinisë, në  
zaman me ba gjana të mëdha, për vendin  
dhe traditën e bukur të Dukagjinit.

Duhen përgëzua këta burra e gra që  
reflektojnë fisnikërinë e zonës, këta njerëz  
bujar i kanë dhanë aq shumë vendit dhe  
kulturës, sidomos në ruajtjen e traditës së  
bukur, që kjo trevë ka dhe po i trashëgon  
ndër breza.

Teje e lumtur që kam kenë e ftume  
dhe bashkudhëtare në këtë udhëtim të

bukur mbushur me arritje, veprimtari,  
vlerësime, çmime nga çdo anë, kjo tregon  
sesa shpirt i kanë dhanë këto njerëz vendit  
të tyre, si askush tjetër në veri...

E paç jetën e gjatë e të mbushur me ar-  
ritje, i shënofshit emrat tuaj në panteonin  
e vlerave atje ku mbretërojnë heronjt, tri-  
mat, burrnia e besa. U kujtofshe e u knof-  
shi si kanga për orët e zanat, shtojzoval-  
let, për burrat që mbrojtën vendin, duke  
dhanë jetën si me le për atdhe...

Shumë urime!

### TV1 Channel - Shkodër

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ka  
festuar 20 vjetorin e krijimit të saj. Kjo  
shoqatë ka dhanë një kontribut të çmuar  
për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave e tra-  
ditave më të mira të trevës së Dukagjinit.

### Nikolin Guri

Urimet e mia të përzemërta për  
datëlindjen tende të 20-të Shoqata Atd-  
hetare "Dukagjini".

Arritjet, sukseset, sfidat dhe puna e  
mirë në këto vite kanë bërë, që kjo shoqa-  
te të jetë shembull dhe model në të gjitha  
trojet shqiptare.

Urime për vlerësimet e merituar atyre  
që kishin fatin të nderohen në këtë ditë të  
20 vjetorit të shoqatës.

Duke shikuar fotot, personat pjesëmarr-  
rës, organizimin dhe çdo gjë tjetër, më  
vjen keq që nuk isha pjesë e kësaj dite të  
shënuar.

Edhe njëherë, urime dhe qofsh jetëgjatë  
shoqata jone, me në krye z. Ndue Sanaj

Ju përhëndes secilin nga ju argatmiret  
e këtyre 20 viteve.

Me shume respekt shumë, Nikolin  
Guri - Lezhe

### Petrit Ndue Suka

Gëzuar e suksese sa ma shumë paçi

lani solli mjeshtërisht shërimin e plagës  
stresuese, sociale e shoqërore.

Një përhëndetje e veçantë erdhi nga  
zoti Gjin Progni, kryetari i Shoqatës "Ni-  
kaj-Mertur", me mesazhin e bashkëpun-  
imit të ngushtë miqësor e vëllazëror ndër  
Dukagjinasi.

në vazhdimësi, faleminderit për gjithç-  
ka Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me në  
krye Ndue Sanaj

### Niko Marku

Urime dhe shumë suksese të më-  
tejshme gjithë kryesisë së Shoqatës Atd-  
hetare "Dukagjini", 20 vite kontribut dhe  
punë për tu vlerësuar!!

### Mhill Shkemb

Respekti të veçanta për të gjithë dre-  
jtuesit e shoqatës, sidomos për kryetarin  
z. Ndue Sanaj.

Ju urojme shëndet e suksese në vazh-  
dim në realizimin e misionit kaq të  
rëndësishme, në shërbim të vlerave të  
Dukagjinit, mbi të cilat mbështetet kombi  
jonë.

### Agron Hasanaj

Urime dhe suksese të tjera në vijimësi  
për Shoqata Atdhetare "Dukagjini"! Fale-  
minderit atyre që e themeluan e drejtuan  
dhe të gjithëve që kanë dhanë kontributin  
e tyre për realizimin e misionit të kësaj  
Shoqate. Respekt!

### Fiku Papekaj

U rritshin sa më shumë vlerat  
shpirtërore të kësaj shoqate. Mirënjohje  
pa fund për të gjithë ju, që e mbështetet  
dhe dhatë fryte të paharrueshme. Të jesh  
misionare i vlerave nuk asht pak ti res-  
pektosh dhe ti mbash ato brez pas brez,  
është një virtyt, por dhe ti shpalosësh  
vlerat është dhurate që zoti të ndihmon ta  
kesh e ta mbash. I përhëndes të gjithë  
pjesëtarët e kësaj shoqate.

### Vat Sokoli

Shumë bukur, është jo vetëm një ri-  
pamje e jetës 20 vjeçare të profilit e ve-  
primtarisë së shoqatës, por edhe një zotim

në ruajtjen e profilit të shoqatës, e cila si  
deri më sot të jete një vlere shpirtërore e  
kulturorë e pa zëvendësueshme për trevën  
e Dukagjinit. Veçanërisht vlerësoj ruajtjen  
në mos rënie të influencave bajraktarit,  
fisnore e të tjera, dhe shembulli i drejtimit  
nga Ndue Sanaj, është prove e kapërcimit  
të këtij rreziku të influencave të ndry-  
shime.

I uroj Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"  
ma të mirën e mundeshme në jetën e saj të  
suksesshme!

### Mark Rupa

Urime të përzemërta Shoqatës Shoqata  
Atdhetare "Dukagjini"! Një shoqate mod-  
el për në Shqipni, me shpirt patriotik dhe  
kapacitet intelektual e kulturor. Me pak  
mbështetje financiare, por me vullnet të  
jashtëzakonshëm për ti dhanë jetë shumë  
gjurmë dhe që sot nderojnë emrin e kësaj  
shoqate, drejtuesit e saj dhe krejt trevën  
tonë. Respekt për Ndue Sanaj, Luigj Shyti,  
Gjergj Leqejzen, Roza Mhill Pjetri dhe  
të gjithë kryesinë drejtues të shoqatës,  
mbarësi dhe vetëm suksese në vazhdim!

### Engjëll Çeka

Uroj gjithmonë suksese shoqatës atd-  
hetare "Dukagjini"!

Megjithëse kisha ftese, për arsye sub-  
jektive nuk munda të marr pjese në këtë  
veprimtari të rëndësishme. Duke ju  
përhëndetur të gjithëve dhe në veçantin  
kryetarin Ndue Sanaj, ju uroj gjithë të mi-  
rat, në realizimin e misionit tuaj!

### Roza Pjetri, përgatiti materialin për botim



# Kirurgu shkodran Shpëtim Ymeri, një pasuri kombëtare në fushën e mjekësisë

Në Spitalin Rajonal të Shkodrës "Jorgji Karamitri", në mes të gjithë atij ekipi mjekësh kirurg e jo vetëm ushtron profesionin e tij edhe kirurgu i shquar Dr. Shpëtim Ymeri. E quaj të tillë pasi të gjithë pacientët apo qytetarët që e njihnin atë e përkufizonin si "Doktori që ta heq t' keqën me dorë". E njoha në mënyrë të sforcuar, pasi angazhimet më bënin të shpërfillja sinjalet e trupit sa herë që kisha shqetësime. Zakonisht merrja një qetësues për dhimbje dhe për pak ditë e harroja, duke mos e kuptuar se situata po bëhej rutinë e po më dilte jashtë kontrollit.

Prej shumë kohësh kisha planifikuar udhëtimin e këtij fund maji për në Kelmend, ku do shoqëroja një miken time regjisore. Ajo quhej Klara Van Es dhe vinte nga Belgjika, për të realizuar një film dokumentar.

Në guidën e saj, kësaj radhë e shoqëronin dy të rinj të mirë edukuar shkodranë (vëlla e motër) pinjoll të familjes Radovani. Vajza përkthente, ndërsa djali i shoqëronte me makinën e tij tip foristradë. U ngjitëm në Selcë dhe zumë vend tek Bar - Restoranti «Selca Cem», për një kafe të shpejtë, ku më pas u nisëm drejt familjes Lumaj, të bënim bashkëbisedimin. Ndërkohë kisha filluar të ndjejë shqetësime në zonën e stomakut. Bashkëbisedimi bëhej me incizim dhe për të mos u dhënë me kuptua të tjerëve, u s'postova pak.

Dhimbjet sa vinin e bëheshin më të forta. Me të mbaruar bashkëbisedimi, jemi nisur urgjent për në Shkodër. Duke parë gjendjen time, familja Lumaj na sugjeroi të ndalonim në Qendrën Shëndetësore - Tamare, për të marrë mjekimin paraprak.

Me të mbërritur në dyert e Spitalit Rajonal të Shkodrës, të tre miqtë, të shqetësuar jashtë mase, më shoqëruan deri sa mbërritën familjarët.

Regjisoria Klara, shumë e merakosur për gjendjen time, njëkohësisht ishte edhe e habitur nga impakti i pare, me shërbimin spitalor në Shqipëri. Megjithëse nuk kuptonte shqip, ajo arrinte të lexonte me përpikmëri gjuhën e veprimeve të këtij shërbimi, gjë që e bëri ta quaj edhe një eksperience të rrallë dhe shumë të nevojshme për projektin e saj.

Me të mbërritur familjarët, ata u larguan gjithë sy e veshë, për të ditur mbi gjendjen time në vijim. Me rekomandimin e Dr. Ardjan Këlliçit - Tamarë, stafi i urgjencës më bëri regjistrimin. Fati deshi që mjek roje atë natë të ishte Dr. Shpëtim Ymeri, i cili do më merrte në patronazh. Nuk e njihja dhe se kisha takuar kurrë më parë. Më vizitoi dhe mbi kartelë shënoi çdo mjekim apo veprim që do më kryeshin paraprakisht.

Në të gjithë atë situatë, për çudi kishte krejt pak pacientë në urgjencë çka bëri të kem një vëmendje të shtuar. E bindur për një helmim rutinë, për habinë time rezultoi të kisha probleme serioze me gjëndrën e tëmthit (gurë, rërë e infeksion), gjendje

që ndoshta kishte kohë që ishte krijuar aty edhe pse analizat i bëja shpesh dhe parametrat dilnin optimal.

Ishte EKO-ja ajo që zbuloi gjithçka dhe në momentin më të keq, sepse krizat po bëheshin edhe më të forta. Pasi mora një dozë të mirë qetësuesish dhe nisa të gjejë pak paqe me vete, pranë krevatit të urgjen-



çës u shfaq doktori me kartelën time tashmë të kopsitur me rezultate analizash dhe vëzhgimesh spitalore.

Zonjë, m' u drejtua Dr. Shpëtimi. Ju keni probleme serioze dhe duhet t'i nënshtroheni një operacioni të shpejtë. Për ta bërë këtë duhet më parë të neutralizoni gjendjen me anë të një kure mjekimesh intensive. Ndërkohë duhet të pini vetëm ujë dhe atë në sasi shumë të pakët. Keni dy mundësi. Të shtroheni dhe të filloni mjekimin intensiv të menjëhershëm ose të shkoni në shtëpi dhe të ndiqni terapinë në kushtet e shtëpisë. Megjithëse isha në pikun e angazhimeve vendosa të qëndroj, pasi trauma e krizës ishte prezent dhe e dija se po të dilja nuk do ta kisha kujdesin mjekësor si në spital. Atëherë dërgojeni në repartin e kirurgjisë për shtrim dhe vazhdoni t'i bëni mjekimet, i dha urdhër personelit të shërbimit në urgjencë.

Sërisht do ta quaj fat që dhoma në të cilën më vendosën ishte përballë dhomës së kirurgëve "Mjek rojë", çka bënte që prezenca dhe vëmendja e tyre të ishte 24 në 24. Ky ishte edhe shkaku që më bëri të shkruaj këtë shkrim të rrallë, të mbështetur mbi eksperiencën personale.

Dr. Shpëtim Ymeri, sikurse çdo njëri nga kolegët e tij kirurg, hynte nëpër dhomat e pacientëve me një autoritet të

jashtëzakonshëm, i shoqëruar nga grupi mbikëqyrës i turnit të shërbimit, porosiste, vizitonte dhe vëzhgonte me mprehtësinë e tij çdo detaj që lidhej me mirëqenien e pacientit. Ajo që binte në sy më së shumti ishte komunikimi me pacientin me një dialog vetëndërgjegjësues, për të mirën e tij në këshilla e në porosi, për orët në vi-

pasi pacienti është qytetar që e ndjen, e ruan dhe transmeton në memorien kolektive të qytetit, vlerësimin ndaj shëronjësit të vet, por kjo nuk mund të thuhet për vëmendjen dhe vlerësimin e shtetit ndaj tyre.

Trajtohen si punonjës shteti dhe vlerësohen sipas sektorit të përgjithshëm të punës, por jo me vlerën e vërtetë të rrolit që kanë në shoqëri. Janë bij të popullit të thjeshtë, por janë heronj të virtutit të lartë human. Nëpërmjet tyre shteti mburret, duke i klasifikuar si fytyra e vërtetë e shëndetësisë falas në Shqipëri, por harron t'i trajtojë me vlerën reale që mbartin këta gardian të shëndetit publik.

Investimi tek kirurgu, mjeku apo shëndetësia, është investim tek siguria kombëtare. Bota i ngre në piedestale për meritat dhe nevojën e përhershme ndaj tyre, ndërsa në Shqipëri prioritet dhe imunitet ka militanti i përkohshëm pa shkollë e pa dije.

Paralel me shëndetin publik punojnë dhe vepronjë edhe spitale private, në të cilat duhet të investosh të marrësh shërbim, por që në të vërtetë veç kushteve të spitalit dhe aparaturave teknologjike nuk ndryshon asgjë, pasi janë po këta kirurg që kryejnë ndërhyrje kirurgjikale, njësoj si në spitalet publike. Atëherë çfarë i detyron këta kirurg të bëjnë punë të sforcuar?

Veç nevojave jetike, këta kirurg duhet të ecin me hapat e shkencës, ku vazhdimisht duhet të investojnë në dije, gjë që i detyron të bëjnë nga dy punë, për të pasur të ardhura të mjaftueshme. A nuk mundet vallë shteti t'u japë prioritet, për të pasur më tepër kohë për veten e tyre, për të shtuar dije shkencore, për të mbrojtur disertacione e studime të thelluara para botës, ku vetë shteti do mburrej me ta, për t'u krijuar kushte e të ardhura të mjaftueshme, në mënyrë që të marrin mbarsht atë që po i ofrojnë shoqërisë?

Këto janë probleme që peshojnë në nevojat e kirurgëve, që pak kush i kupton, sepse në përditshmëritë e tyre ato nuk janë prioritet, pasi ata punojnë në heshtje, duke mbrojtur shëndetin tonë 24 ore në 24 ore.

Këta janë heronjtë e ditëve tona, të cilët i takojmë dhe u kërkujmë ndihmë vetëm kur kemi betejën tonë të mbijetesës për jetë a vdekje. Por ata janë aty për ne dhe të afërmit tanë, për një mision të shenjtë, nëpërmjet të cilëve Zoti përmbush edhe planet e veta, duke i shndërruar edhe në engjëj mbrojtës të njerëzve mbi tokë.

Ndaj gjej rastin të shpreh mirënjohje të përjetshme Dr. Shpëtim Ymeri dhe gjithë ekipit të kirurgëve, si dhe mjekëve të Spitalit Rajonal të Shkodrës, për punën vetëmohuese në të mirë të shëndetit tonë publik.

**Nga Rita Shkurtaj,  
qershor 2023**

jim. Pas çdo vizite gjatë atyre ditëve, në mëndje m' u ngulit një pyetje.

A thua vallë ua di vlerën këtyre kirurgëve qyteti i Shkodrës?

Shteti apo Kombi Shqiptar?

Dr. Shpëtim Ymerin e njohin të gjithë në Shkodër dhe e trajtojnë me respektin më të madh, si doktor kirurg e ca më tepër si njeri i depolitizuar, që gjithë jetën e tij e ka vënë në shërbim të shëndetit publik, duke luftuar me vdekjen në çdo rrethanë, e mbrojtur me dinjitet, me profesionalizëm e me zemër jetën e secilit pacient që bie në duart e tij.

Puna e kirurgut nuk ka sy e veshë për ta vëzhguar në transparencë mediatike, pasi janë rrethanat e punës që kushtëzojnë atë, por ka rezultate të matshme në qindra e mijëra Shpëtime jetësh, në bekime e gëzime zemrash, sa herë pacientët gjejnë shërim nga ndërhyrja kirurgjikale e këtyre heronjve të ditëve tona. Dhe kjo është vetëm njëra anë e medaljes, pasi për të fituar ato dije dhe aftësi profesionale, çdo njëri nga ata ka investuar dhe udhëtuar në kohë me librat dhe me sfidat e mëdha të shkencës, për të qenë këta profesionist të spikatur të kirurgjisë që na shërbejnë ne sot.

Në të vërtetë, pacienti e gjen gjithmonë rrugën për t'ia shprehur mirënjohjen e tij,



# Shpallën “Qytetar Nderi i Tropojës” Sali Morina dhe djali i tij Sokol Sali Morina

Këto ditë Këshilli Bashkiak i drejtuar nga Kryetarja Shota Basha dhe Bashkia Tropojë me Kryetar Rexhë Byberin, në qytetin Bajram Curri, organizuan veprimtarinë për dhënie të titullit të lartë “Qytetar Nderi” i Tropojës, bijve të Kosovës kreshnike, babë e djalë Sali Morina e Sokol Sali Morina.

- Kishin ardhur intelektualë të fushave të ndryshme, nga Gjakova, Prizreni, Tropoja, Tirana dhe Shqiptarë me banim në Amerikë.

Në kujtimet që ka lënë Sali Myftar Kolgeci, për ish mësuesin e tij Sali Morina, për periudhën 1924 - 1926 punojë në detyrën fisnike të mësuesit, drejtor i shkollës konvikt (internat) “Kosova”, dhe më vonë Sali Morina, nderohet edhe me titullin “Mësues i Popullit” për veprimtarinë e tij në shkollën e parë Shqipe të Malësisë Gjakovës, janar 1923, në fshatin Bujan, te shtëpia e Ali Jakupit në Dojan.

Në muajin Mars të atij viti 1923, shkolla u shpërngul nga Bujani në fshatin Kolgecaj (sot qyteti i “B. Curri”) dhe u vendos në ndërtesën e ish prefekturës të cilën ia kishin marre Mulla Dautit, forcat e ushtrisë Austro - Hungareze për ta përdorur për zyrë të tyre.

Meqenëse Nën Prefektura u transferua atë vit në fshatin Tropojë dhe qëndroi atje deri në vitin 1950, kjo ndërtesë tashmë shërbeu për vendosjen e shkollës dhe më vonë të konviktit (internat) “Kosova”, ku u siguruan kushte shumë të mira për zhvillimin e procesit mësimor - edukativ dhe sigurimin e kushteve të jetës së nxënësve konvikt-bursist.

Në vitin shkollor 1923 - 1924 shkolla kishte dy klasë, të parën dhe të dytën.

Në katin e parë u vendos zyra e drejtorit të shkollës, salla e personelit dhe salla e ngrënies për konviktoret. Në katin e dytë ishin dy klasa për mësim, ndërsa në katin e tretë ishte fjetorja për konviktoret. Gjatë punës që po bëhej për hapjen e konviktit, nxënësit konvikt - bursist u strehuan në shtëpinë e Sali Manit, në Bujan, në atë të Bardhec Hajdarit në Kolgecaj dhe të Shpend Balisë në Margegaj, ku aty banonte edhe Bajram Curri.

Shkolla - konvikt (internat) “Kosova” u hap në Kolgecaj në vitin shkollor 1923 - 1924 dhe vazhdoi aty deri në vitin shkollor 1928 - 1929 dhe me urdhër të Ministrisë së Arsimit atë vit u transferua në Krumë të Hasit ku ishte qendra e Prefekturës.

Tashmë atje, në konviktin e Krumës ishin të regjistruar 122 nxënës me bursë, ku 22 prej tyre ishin nga Tropoja. Shkolla e parë shqipe në Malësinë e Gjakovës, është hapur në Bujan në vitin 1923 dhe këtë e vërteton me dëftesën e shkollës të lëshuar nga mësuesi i tij i atij viti Mana Shaqa (Osman Shaqiri), i cili shërbeu në shkollën konvikt (internat) “Kosova” nga viti 1923 deri në vitin 1928.

Në vitin shkollor 1923 - 1924 numri i nxënësve u shtua me ardhjen e të rinjve nga Prefektura e Kosovës ku 50 nxënës u trajtuan me bursë.

Fillimisht drejtor i parë i shkollës në

Kolgecaj ishte Niman Ferizi, sekretari personal i Bajram Currit, i cili në dhjetorin e vitit 1923 largohet për në Tiranë pasi u zgjodh deputet i Tropojës, kështu detyrën e drejtorit e mori mësues tjetër Gjakovar Ibrahim Fehmiu i cili jepte mësim në klasën e dytë, ndërsa në klasën e parë jepte mësim Mana Shaqa.

Nën drejtimin e tij, nxënësit e mësuesit e shkollës morën pjesë aktive në ngjarjet e revolucionit të Qershorit të 1924, ku ndër të tjerë u dalluan Asim Vokshi e Sali Myftari (Kolgeci).

Në vitin arsimor 1924 - 1925 shkolla



pati një rritje në numër ku 77 nxënës ishin me bursë nga Luma, Tropoja dhe Hasi.

Në vitin shkollor 1925 - 1926 numri i nxënësve dhe mësuesve ishte shtuar në shkollën - konvikt “Kosova”. Aty kishin shkuar nxënës nga Luma, nga konvikti “Naim Frashri” i Tiranës.

Trupa mësimore atë vit përbëhej nga:

1.Sali Morina drejtor i shkollës, me cilësinë e inspektorit për të gjitha shkollat e qarkut të Kosovës, për rrethet Tropojë, Has e Kukës. Njëherësh ishte edhe mësues për klasën e 5 e të 6 kolektive.

2.Ibrahim Kolçi, mësues për klasën e katërt dhe kujdestar i konviktit.

3.Osman Shaqiri (Mana Shaqa) mësues për klasën e tretë .

4.Qazim Haraçiu, mësues për klasën e dytë.



Çaste nga marrja e titullit “Qytetar Nderi” i Tropojës për Sali Morinën nga mbesa e tij Dinora

5.Hysen Tenolli, mësues për klasën e parë.

Në kujtimet e Sali Kolgecit, ai shkruante:

“Sali Morina ishte i mrekullueshëm. Ne e dëgjonim me tan sy e veshë. Kishte një horizont të gjerë dijesh. Veç kësaj punonte me shumë pasion e ambicie. Por i kushtonte kujdes të madh edhe anës argëtuese të nxënësve. Ai kishte një metodë

mësimdhënie të shkëlqyer, punonte edhe përdorte tekste dhe enciklopedi të ndryshme në gjuhën turke, njëherësh shfrytëzonte edhe literaturën e lënë nga Ibrahim Fehmiu i cili kishte dalë në emigrim. Rëndësi të veçantë u jepte lëndëve shkencore gjuhë shqipe, hartimit, matematikës, fizikës, historisë dhe gjeografisë duke synuar në formimin e botëkuptimit shkencor të nxënësve. Për këtë qëllim organizonte ekskursione e vizita në vende ku ishin zhvilluar luftime e ngjarje historike për mbrojtjen e tokave shqiptare. Përgatitje të veçantë bënte me nxënësit për festën e fl-



amurit 28 Nëntorit ditën e shpalljes së pavarësisë, kështu mund të përmendim udhëtimin tre ditor në këmbë përmes shiut e dëborës me 25 - 27 Nëntor 1925 nga Kolgecaj në Krumë e Kukës, me nxënësit nën drejtimin e tij për të festuar 28 Nëntorin, ditën e pavarësisë”.

Po me këtë datë 28 Nëntor 1925 nxënësit e shkollës - konvikt “Kosova” nën drejtimin e mësues Sali Morinës dhanë një program artistik në Krumë, në qendrën e prefekturës, ku shfaqën komedinë “Vëllazëri dhe interes” të Floqit.

Ai, me autoritetin e drejtorit të shkollës internat “Kosova” dhe të inspektorit të arsimit për qarkun, përveç kujdesit që kishte për të gjithë nxënësit si një prind i mirë, mundi të siguronte bursa për shkollën e mesme për nxënësit që shkëlqyen në



Kryetarja e Këshillit Bashkisë Shota Basha me kryetarin e Bashkisë, Rexhë Byberin duke i dhënë titullin e lartë “Qytetar Nderi” i Tropojës Sokol Morinës

mësime dhe konkretisht nxori bursa për në shkollën normale të Elbasanit për Sali Kolgecin, Rexhep Shpendin dhe Asim Vokshin, por Asimi shkoi në gjimnazin e Shkodrës, ku u bashkua me rininë përparimtare të kohës.

E burgosën, por mbas daljes nga burgu në vitin 1936 shkoi në Spanjë në luftë kundër fashizmit, ku flijoi jetën për lirinë

e popujve, ndaj shteti ynë e ka shpallur “Hero i Popullit” dhe ka përjetësuar me emrin e tij gjimnazin e qytetit “Bajram Curri” dhe pallatin e kulturës në Gjakovë”.

Edhe i biri i Sali Morinës Sokoli, i cili jeton sot në Tiranë ka një aktivitet të pasur, kryesisht në fushën e sportit. Sokol Morina mbeti gjithmonë një legjendë e Sportit Shqiptar, si sportist, mësues, pedagog, drejtues i sportit, kryetar i fizkulturës Tiranës dhe përgjegjës i klubit sportiv Dinamo. Sokoli do të vlerësohet për dashurinë, respektin, bashkëpunimin e ndihmën që ka dhënë në vite mësuesve të edukimit fizik të Tropojës si: Ibrahim Shabani, Dan Doçi, Isa Sherifi, Rexhep Mustafa, Halil Gjongeci, Cenë Haklaj, Bajram Gjyriqi, Shpend Hoxha, Shkëlzen Logu, Nuredin Seci, Çelë Hajdari, Avdyll Doçi e Xhafer Hoxha.

Këta si familje me origjinë nga Gjakova, shpërngulën në Shqipëri në vitin 1913.

Sokoli në vitin 1953 deri në vitin 1965 shpallet kampion në garat 800 metra dhe 1500 metra.

Në spartakiadën e parë kombëtare ka marrë 3 medalje ari.

Me 6 Mars 1966 në Bullgari për krosin Ballkanik, Shqipëria zë vendin e parë si ekip i vajzave, me trajner Prof. Sokol Morinën.

Nga viti 1969 - 1971 krijoi ekipin e atletikës të klubit sportiv “Dajti” dhe njëkohësisht profesor në IKF “Vojo Kushi” në Tiranë.

Në vitin 1971 - 1975, në Ministrinë e Arsimit, Kulturës, inspektor për edukimin fizik. Nga viti 1975 - 1987 kryetar i Komitetit Fizik të Tiranës, duke hapur për herë të parë klasa sportive në shkollat e kryeqytetit.

Në vitin 1987 përgjegjës i klubit sportiv “Dinamo” i cili ky klub shpallet më i miri në shkallë republike. Disa herë është dekoruar me medalje dhe urdhra “Naim Frashri” nga Presidentët e Republikës, duke marrë edhe titullin “Mjeshtër i Madh”.

Të shumtë ishin ata që e morën fjalën në këtë veprimtari të larmishëm, si Ali Demushi N/kolonel në pension, Ali Qerimi, major në pension, Man Doçi biznesmen, Arben Hoti nga Lidhja e Shkrimtarëve Prizren, Xhevat Kokoshi drejtor i parë i gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë, Çel Hajdari profesor i edukimit fizik, vajza intelektuale e Sokolit, Dinora. Gjithashtu Sokoli mori edhe nga Biblioteka e B. Currit disa libra dhuratë.

Pjesëmarrësit i përshëndetën me këngë këngëtarë të mirënjohur Bashkim Muça e Rustem Muça.

Për pjesëmarrësit u shtrua edhe një drekë në lokalin “Sylbica” me përgjegjës punëtorin e palodhur Hysni Ahmetaj. Gjatë drekës Ansambli “Dardania” i qytetit B. Curri përshëndeti pjesëmarrësit me këngë e valle.

**Ibrahim Hajdarmataj,**  
**Kryetar OJF-së “Arsimtarëve”**



# Shkrimtari i humorit Paulin Selimi

**Jeta e shkrimtarit të humorit,  
Paulin Selimi**

*"Vita brevis Ars Longa"*

Paulini lindi në lagjen G'juhadol në një familje me origjinë prej Dushmanit. I ati, Sokoli, qe me origjinë nga krahina e Dushmanit të Dukagjinit, kurse e ama, Danica, ishte nga Tivari, i Malit të Zi.

U lind në një ditë të ftohtë nëntori në G'juhadol dhe ishte gazimi i parë i familjes Palli (Sëllimi). U rrit me dashurinë e madhe të prindërve dhe gjyshes, që e kishte gëzimin e pare nga djemtë. Më vonë në këtë familje do të vinin edhe kushërinjtë e tij Lucjana, Aleksandri, Viktori, Gjergj Pali. Ishte më i madhi nga fëmijët në shtëpi dhe shpesh luante me ta dhe me fëmijët e lagjes. Lojërat ishin të bukura dhe jo luf-tarake. Ju shfaqte fëmijëve film të shkurtër pa zë (kishte një aparat që ja kishin sjelle peshqesh nga Italia). Aty mblidheshin të gjithë dhe secili do të paguante për skenën që shihte. Sapo kishte lexuar Pinokun dhe i thotë një shoku të klasës që kishte gjithmonë leke neper duar: Do të të shtohen leket? Posi i thotë shoku! Futi këtu tek vrima në mur dhe pas një jave do të marrësh dyfishin. Dhe lojëra të tilla nuk kishin të mbaruar. Një dite po griheshin kojshite se, kishin plagosur pulën në këmbë! Kush e plagosi pulën pyesnin të zotet e pulës së gjore. Paulini që e kish pare skenën thotë:

Kush ja theu këmben pulës?

Çesku i vogël, djali i Lules.

Ishte vetëm 8 vjeç dhe improvizoi bejten që Çesku ma tregoi para 2 vitesh.

Nëse i falte dikush ndonjë monedhe ai shkonte dhe blinte libra. Lexonte deri vonë edhe pse i fiknin dritën, ai ndizte qiriun. Në dimër kishte ftohte dhe thoshte se si nuk ka një objekt që të shfletoj faqen për të mos nxjerre dorën nga jorgani.

Një dite një fshatar me një gomar me dru po kalonte pranë shtëpisë. Ky e sheh dhe i theret. Fshatari shkoi drejt shtëpisë dhe hyri brenda. Nena e tij e pa dhe u habit! Kush të tha ty të sjellësh drutë? E pyeti ajo. Ky djali, thotë fshatari. Po ky është 7 vjeç more, ku di gjë ky që ne i kemi marre drutë për këtë dimër? Dhe ky djali i vogël mendonte për shtëpi se i mungonte prania e të atit, për vite të tera. U rrit me shumë mundime nga nena e tij fisnike dhe nga axha Zef, Florenca, dhe gjyshja e tij e dashur.

Në këtë qytet mori mësimet e para dhe ato të mesme (Shkollën fillore tek shkolla "Vasil Shanto", të mesmen tek shkolla "Jordan Misja"), të cilat i përfundoi me 1965. Po këtë vit u regjistrua në fakultetin Histori-filologji, dega Gjuhë-Letërsi, në Universitetin e Tiranës, të cilin e përfundoi në vitin 1969.

Kur ishte nxënës i vitit të dytë të gjimnazit, mësuesi i letërsisë Neki Lezha ju dhe nxënësve një teme të lire, për të bërë hartim. Paulini me laps në një dy fletësh bëri një hartim, që e çuditi profesorin. I thërret dhe i thotë se, ka një talent të veçantë dhe se duhej të orientohet tek gjuhe-letërsia.

Në vitet e shkollës së larte spikati talenti i tij për humorin. Një dite poeti Xhevahir Spahiu e ndal dhe i thotë, që duhet

të lëvroje humorin si gjini. Filloi shkrimet e para ti botoje në gazetën "Studenti" dhe në gazeta të tjera periodike. Në një ore leksioni profesori i tij i nderuar Shaban Demiraj, i thotë: Paulin duhet të shkruash në gjuhë letrare, se lexohesh më gjere me shrimet e tua. Dhe Paulini i thotë: Dakord profesor, por nëse fjalën bani do ta beje beri. Po emrin tuaj si duhet ta bej? Shaberi? Gjithë salla filloi me qeshe.

Pasi mbaroi fakultetin u transferua në Pukë dhe më vonë në Kukës, ku punoi disa vite. Në Kukës bënte ftohte dhe shëndeti i tij nuk e përballonte të ftohtin dhe kërkonte vazhdimisht të transferohej. Për këtë e ndihmoi Mhill Doçi (I ati i poetit Agim Doçi), i cili në atë kohe ishte Kryetar i komitetit ekzekutiv të rrethit Kukës. Gëzimi i tij ishte i madh, sepse nuk mund të komunikonte lehte. Ishte rruge e largët dhe shumë e vështirë për tu bere në atë vite. Paulini ishte djali i vetëm dhe prindërit e donin afër.

Pas transferimit nga Kukësi, Paulini punoi disa vite në shtëpinë e "Pionierit" në Shkodër. Ishte masovik dhe organizonte veprimtari të ndryshme kulturore, artistike, konkurse, festivalet kombëtare të fëmijëve, duke shkruar edhe tekste këngësh për fëmijë.

Në festivalin e vitit 1970 fitoi çmimin e pare me këngën "Beni, Mira dhe reçeli". Më vonë vijon me krijime të tjera për festivalet e fëmijëve. Por kjo gjë e bukur nuk zgjati shumë se e larguan nga puna për të emëruar njerëzit e lidhur me pushtetin. Tani fillon kalvari i transferimeve nga një shkollë në tjetrën.

Në gazetën "Jeta e Re" punoi ca kohe në detyrën e bashkëpunëtorit të jashtëm, por që merrej edhe me kujdesin e botimit në shtypshkronje.

Aty u njohëm bashke. Gazeta shtypej në darke dhe Paulini më pa në dyert e fakultetit. I vinte turp të më ndalonte vete dhe kërkoi ndihmën e Zhaneta Shqepes, gazetares e re që vinte nga Pogradeci. Ajo jetonte në të njëjtin konvikt me mua, dhe një dite i shoh te dy duke u ulur nga shkallet e institutit. Dëgjoj një zë që thotë: Kjo vajza është... dhe që nga ky moment ecejaket u shtuan nga Zhani tek unë. Kuptohet, ishte një shkuesi moderne. Na prezantoi në një ditë të ftohte janari tek Posta. Zhani u largua dhe na la vetëm te dy në shkallen e postes. Biseduam pak dhe u habita sa bukur fliste, sa delikat ishte kur më mbronte me çadrën e tij, me delikatesën kur më shtrëngonte dorën. Aty mora vesh se artisti lind dhe nuk kultivohet lehte.

Gjate fejesës tone 2 vjeçare jam mrekulluar me personalitetin e tij. Ishte vetëm 28 vjeç dhe kishte kaq miq sa më befasonte.

Kur uleshim në lokal menjëherë rrethesh mblidheshin miq dhe dashamires. Kishin dëshire ta dëgjonin kur fliste, me kulturë të gjere dhe me humor të hollë.

Paulini kishte sy të bukur dhe një lëkure të bardhe. Une e ngacmoja duke i thënë: A erdhi Alen Delo? Ai qeshte, se i pëlqente të përkëdhelej. Kaluam dy vite të bukura në Shkodër, duke shkruar në shfaqjet, ku ai ishte shkruesi i tek-



Paulin Selimi (Shkodër, 19 nëntor 1947 - 22 janar 2013)  
që mësues dhe letrar shqiptar

steve, në kinema, në vizita tek miqtë dhe njerëzit e jashtëzakonshëm të qytetit, që u bë menjëherë edhe imi. Në një veprimtari, për San Valentinin, të zhvilluar vitet e demokracisë na kishin ftua te dyve. Drejtuesja e pyet Paulinin se, çfarë peshqeshi i ke blere gruas për festat e San Valentinos nder vite, ky i tha! Nuk kam pasur shumë leke neper duar, por një nate dimri kur po e përcillja Donikën në konvikt, pashe që ajo po mërdhinte. Hoqa pallton time dhe e mbulovala me te, ndërkohe unë isha me xhakete....

Por transferimet nga një shkollë në tjetrën, në rrethinat e qytetit e mërztin



Paulini në mes aktorëve të teatrit "Migjeni",  
në mes tyre dhe Mjeshtri Fadil Kraja

pak. Pas disa vitesh zëvendësues u transferua në shkollën e mesme pedagogjike "Shejnaze Juka", në të cilën punoi për 22 vite. Ishte transferimi i tij edhe një ogur i mire, sepse u bë baba, për here të pare, me djalin tone Eltonin. Kur erdhi djali në jete gëzimi i tij ishte i papërshtueshëm. Isha në pritje të ëmbël kur më thotë: Djali ynë do të jete me sy si unë dhe me talentin tim. Po ku e di ti se është djalë? Ai thoshte:

Une e bej majmun po e bej gjinia mashkullore... Në këtë kohe filloi të merrte edhe lejen e krijimtarisë, e cila e ndihmonte për të punuar në artin e tij. Punonte në një makine shkrimi dhe pasi i mbaronte së shkruari mi lexonte. Une si "eksperte" i thosha mire, mire, por kjo nuk shkon. Mos ekzagjero... Pas pese vitesh u shtuam edhe me një vajze topolake. Vanda ishte dashuria e tij e madhe. Shpesh më lutej të dilnim me fëmijë. Po unë isha mësuese në fshat dhe vija vonë nga puna. Paulini me Tefen merrte djalin me karroce dhe shkolin në turizëm. Njerëzit qeshnin kur i shihnin se, te dy përkujdeseshin deri kur fillonte të qarat. Ma sillnin në shtëpi dhe nuk e merrnin ma. Pse i thosha nuk e mbajtët edhe pak? Po nuk pushonte së qari edhe pse i këndoja nina baba!

Paulini ishte i kujdesshëm me mua dhe me familjaret e tij. Veçanërisht nenën e donte shumë. Ajo nuk kishte njerëz të saj në Shqipëri dhe vetëm këtë djalë kishte. E donin shumë njeri-tjetrin, dhe sa here vinte në shtëpi i binte diçka.

Në vitet 80-87 kontribuoi për Radio Televizionin Shqiptar në programacionin e mbrëmjeve të vitit të ri. Ishin vite të arta në krijimtari dhe në familje. Me honorarët e marra blinte here një biçiklete, here ndonjë dhurate për fëmijët, por më shumë merrte duartrokitjet e dashamirësve të humorit.

Paulini, duke ndenjur me njerëz njihje gjithkënd. Kur e pyesja unë për ndonjë person ai thoshte! Është njeri i mirë. Nuk shante asnjë njeri, edhe pse ja bënë me borxh. Kudo që rrinte njerëzit i shkonin nga mbrapa. Vinte në shtëpi i lodhur, sepse edhe tryezat ishin impenjative. Vinte njerëz që donin të kalonin disa çaste të bukura me te. Mua më vinte inat, se ai mbante mbi vete hallet e të tjerëve dhe e kalonte masën e pijes.

Drama më e madhe e jetës së tij ishte Janari I vitit 1988. Një makine çan kufirin në Hanin e Hotit. Ishin të gjithë kushërinjtë e tij. Ikën në boten e lire, duke na lenë të përplasemi me barrën e dashakeqësisë së pushtetit. Dihej, që Komiteti i Partisë nuk e kishin me sy të mirë Paulinin për humorin që ai bënte. Tani ju dha rasti që ta syrgjynosnin në fshatin



# Një intelektual dhe drejtues shembullor, Fran Marku

Të flasësh për njerëz të mirë, të drejtë, të thjeshtë dhe humanë dhe për intelektualë dhe drejtues të aftë, të përkushtuar, profesionistë, komunikues dhe bashkëpunues, të cilëve u ka ecur fjala dhe puna, kanë pasur rezultate dhe kanë lënë emrin e mirë dhe gjurmë të pashlyera tek bashkëpunëtorët dhe njerëzit edhe pse del në pension, duke gëzuar kurdohërë respektin dhe mirënjohjen e tyre, është një obligim i madh, por kur ke çfarë të shkruash për të, është një kënaqësi dhe arritje për një gazetar dhe publicist. Si i tillë, kjo më nxiti, që të shkruaj me kënaqësi për mikun tim të kahershëm, birin e trevës fisnike të Dukagjinit, me kulturë, histori, dije, qëndresë, atdhetari e bujari, intelektualin e aftë e korrekt dhe drejtuesin shembullor e rezultativ Fran Marku, nga Rrila e Lezhës, me modestinë dhe fisnikërinë, fjalën e mirë dhe buzëqeshjen e modestinë, që e karakterizon edhe kur e përshëndet, kur bisedon e pi kafe me të, me të cilin ke çfarë mëson, bashkëbisedimin ia bëra me modesti, karakteristikë e këtyre njerëzve, që nuk duan të duken, por që u flet puna, profesioni, humanizmi sinqeriteti, fisnikëria dhe thjeshtësia, siç e kanë në natyrë malësorët e asaj malësie kreshnike, Frani dhe familja e tij e nderuar, duke trashëguar vlera dhe virtyte të mira si malësorë të mirë, punëtorë, mikpritës dhe fisnikë.

## Kush është Fran Marku?

Intelektuali Fran Marku, nga Rrila e Lezhës, ka lindur me 24 prill 1951, në fshati Khan të krahinës së Pultit, Dukagjin, me prindër bujarë e punëtorë, ba-



bai, Zefi dhe nëna, Drande.

Frani, shkollimin 8 vjeçar e mori në fshatin e lindjes, Khan; ndërsa të mesmen në shkollën ekonomike, në qytetin e Lezhës dhe fakultetin ekonomik, dega plan në Tiranë.

Familja e tij janë larguar nga fshati Khan për në fshatin Rrilë-Lezhë, në vitin 1970, për arsye ekonomike.

Fran Marku, ka një karrierë dhe përvojë të pasur e të suksesshme, me përkushtim, korrektësi e profesionalizëm, arsimin tetëvjeçar e bëri në vendlindjen e dashur, fshatin Khan, që e kujton me mall e nostalgji, duke shkruar herë pas here; të mesmen në shkollën ekonomike në qytetin e Lezhës dhe të lartën, për Ekonomi-Plan, në Universitetin e Tiranës, me rezultate

të larta. Gjithashtu ka kryer dhe dy kurse kualifikimi e trajnime pas vitit 1990: Për kontabilitetin e ri të aplikuar në Republikën e Shqipërisë, për financat publike nga një fondacion Skocez dhe për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë dhe sistemin e sigurimeve të detyrueshme.

Frani, duke filluar punën, në detyrën e ekonomist në Rrilë, Lezhë; më 1973, në detyrën e përgjegjës të Sektori, te Hoteli i Gjuetisë, në Lezhë;

Në vitin 1975-1983, Sekretare i këshillit popullor te ND bujqësore Lezhë.

Në vitin 1983-1986, Brigadier (stazhi I partisë) 3 vite në prodhim.

Në vitin 1986-1989, Përgjegjës sektori NB Lezhë (hoteli I gjuetisë).

Në vitin 1989, Përgjegjës sektori NB Rrilë.

Në vitin 1989 - 1991, në detyrën e drejtorit, në NB Lezhë (Rrilë, Shënkolle e Tale;

Në vitin 1992- 1996, në detyrën e shefit të Financës, në komunën e Shënkollit dhe nënkryetar i saj; Në vitin 1997- 2001, në detyrën e drejtorit për Buxhetin, për Qarkun e Lezhës;

Në vitin 2001-2006, në detyrën e drejtorit të Tatim- Taksave, për Qarkun Lezhë;

Në vitin 2006- 2016, në detyrën e drejtorit të një Kompanie Sigurimesh, "AT-LANTIK" sha në Qarkun e Lezhës e të tjera.

Në vitin 2016, Frani del në pension.

Fran Marku, përveç detyrave shtetërore ka kryer dhe detyra shoqërore:

Në vitin 1973-1982, Sekretare I Komitetit të Rinisë NB Lezhë dhe anëtar i byrosë së rinisë për rrethin e Lezhës.

Frani, në vijim, administron, bashkë me familjen e tij, një biznes privat.

Detyra dhe përgjegjësi të kryera me sukses, korrektësi, rezultate e përkushtim, nga intelektualin dhe drejtuesin i mirënjohur Fran Marku, që përveç këtyre detyrave, ka kryer edhe detyra shoqërore e të tjera: Ka qenë anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë, anëtar i Këshillit të komunës Shënkolle, Lezhë, kandidat për kryetar Komune Shënkoll, Lezhë, kandidat për deputet,

sekretar i Komitetit të Rinisë NB, Lezhë, në vitet 1974-1982; në vitin 1992-1999, anëtar i këshillit Komunës Shënkolle; në vitin 2015-2019, anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë; dhe detyra të tjera, si dhe drejtues korrekt i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dega Lezhë.

Janë detyra dhe përgjegjësi, që flasin e frymëzojnë në çdo kohë, me kontributin e madh dhe përgjegjësi profesionale të z. Fran Marku, një njeri, intelektual, drejtues dhe familjar model, te i cili ke çfarë të mësosh nga jeta, profesioni, detyrat e ngarkuara, veprimtaria e pasur dhe përvoja e madhe në vite, duke lënë emrin e mirë, qytetarinë, respektin dhe mirënjohjen e thellë tek bashkëpunëtorët, njerëzit, qytetarët dhe gjurmë të pashlyera në kujtesën e secilit.

Gjendja familjare:

Frani, është martuar në tetor 1976 me Zj. Mrike Marku nga fshati Shënkolle, me origjinë Mirditore, diplomuar për agronomi dhe punuar ekonomiste NB Lezhe, në vitet 1975-1992. Pas vitit 1992 deri në dalje në pension, në vitin 2015, është administratore e një biznesi privat.

Kemi tre djem:

Eltoni, lindur me 20 Qershor 1977, diplomuar për Histori-Gjeografi, emigruar në Itali, në vitin 2000 dhe prej 9 viteve është në SH.B.A, Houston, Texas, i martuar me Yuodenis Marrero Gonzales (Kubaneze) dhe kanë 2 fëmijë: Friden e Alehandron.

Erditi, lindur me 25 gusht 1983, i diplomuar për juridik dhe punon ne Qarkun e Lezhës, është i martuar me Valentinën dhe kanë 2 fëmijë, Frenkun dhe Vivin.

Elision i diplomuar për ekonomi dhe prej vitit 2015 administrator një biznes privat.

Frani për punën e bërë me shume përkushtim, në vitin 1985, është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, me medaljen "Për meritat të shquara shtetërore e shoqërore".

**Përgatitë Jak Rrozhani, gazetar e publicist**

◀ Toplanë. Por njerëzit e donin shumë dhe se linin vetëm në ato momente të vështira. Jani Malo, Paulin Shtjefni, i ndenjen afër në ato kohe të vështira dhe e ndihmuan që ta kalonte atë drame të jetës së tij. Pas një periudhe të vështire, Paulini rifilloi punën edhe një here në shkollën pedagogjike "Shejnaze Juka". Ishte 7.30 dhe të gjithë nxënësit të rreshtuar në hyrje të shkollës. Sa panë profesorin të vinte në shkollë, gjithë shkolla buçiti nga duartrokitjet e nxënësve. Kjo i dha një forcë të jashtëzakonshme për të vijuar me krijimtarinë e tij. Ishte koha kur shkroi "Kolen e Dritave" kalvarin e vuarjtjeve të tij. Gjithë jetën kokën ulur, fajtori pa faj. Por nuk zgjati shumë kjo situatë. Erdhën vitet e demokracisë dhe u çlirua nga frika e ndonjë hakmarrje të re.

Filloi epoka e një krijimtarie pa doreza, e çliruar nga nënkuptimet, duke prekur dukuri negative të shoqërisë. Thirrjet për të kandiduar për deputet, për parti të shumta politike, bashkëbisedime, botime në media, botime librash, esesh, studime, filluan me shumice në këtë periudhe. Por ai nuk pranoi të futet në boten e politikës. Dhe mirë ka bere.

Paulini thoshte shpesh se, unë jam demokrat, por jam boje qielli dhe jo blu. Nuk i pëlqente zhurma e forte politike. Shpejt u zhgënjye nga "demokracia" e rrejshme. Në vitet 1995-1996 vizitoi "armiqtë" e popullit në SHBA, Itali, France, Zvicër, por nuk pranoi të jetoje atje. Kishte venë një emër në Shqipëri dhe nuk dinte të punonte gjë tjetër.

Krahas punës si arsimtar shkroi edhe shumë vepra humori stikë, që e ngritën në një nivel të lartë dhe të kulturuar humorin shkodran. Ka shkruar komedi, skeçe, ese, epigram, poezi, tregime e të tjera dhe shumë emisione humori stikë në radio Shkodra.

Me këtë veprimtari të madhe në fushën e humorit, Paulini do të bëhej një nga shkrimtarët e humorit më të dëgjuar dhe më të pëlqyer të kohës, jo vetëm në Shkodër, por në gjithë vendin. Nuk është rastësi, që Paulini do të behej shkrimtar. Ai ka lexuar me mijëra libra, të cilat i blinte me ato pak para që i falnin, por i merrte edhe tek miqtë e tij.

Në shkrimet e tij humoristike, ai diti të fshikullojë problemet e mprehta të shoqërisë shqiptare, duke i veshur atyre

humorin e mprehtë dhe të hollë shkodran. Nga viti 1991 -2001 ishte kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shkodrës. Gjate kësaj periudhe zhvilloi një sere veprimtarish, për të zgjuar talentet e reja, që bënin humor, promovime librash, beri libretet e karnavaleve, konkursin e bejtexhinjve e të tjera. Nuk beri kurrë pakt me mediokritetin. Ishte selektues në ato libra që botoheshin në atë kohë.

Nga viti 2002 -2011, drejtor i shkollës së Muzikës "Prek Jakova". Shkolla e muzikës, vendi ku zhvillohen talentet e reja, ishte lenë në mëshirë të fatit. Me njohjet e tij arriti të gjeje fonde, për rikonstrukcionin e shkollës dhe për ta kthyer në çerdhe të artisteve të rinj. U lidh me një fondacion Zviceran dhe e pajisi shkollën me vegla muzikore dhe me mjete të tjera për shkollën. Një dite ftoi të gjithë prindërit në sallën e koncerteve dhe ju dha me firme veglat muzikore për fëmijët e tyre. Të gjithë ndihmat humanitare të ardhura enkas për shkollën jua shpërndau prindërve dhe nuk la vend për abuzime.

Më 2002 dekorohet nga Presidenti i Republikës me Urdhëron "Naim Frashëri i Artë"; Këshilli Bashkiak i Shkodrës e ka

nderuar me titullin "Mirënjohja e qytetit". Ndër botimet e tij humoristike spikatën:

- \* "Gati orkestra", në vitin 1972,
- \* "Një skeç për veten", në vitin 1977,
- \* "Banor i shkallës së lartë", në vitin 1981,
- \* "Nuk shihet fytyra vetëm tek pasqyra" (epigrame), në vitin 1985,
- \* "E drejta e natës së parë" në vitin 1994;
- \* "Duel gjelash", në vitin 1997 dhe në vitin 1999, dy botime.

Në Krye të kësaj monografie është thënia latine "Vita brevis Ars Longa", jo pa qellim e kam vene aty. Shpesh thoshte, kishte ndjesinë që nuk do të rronte gjate. Por s'ka gjë, thoshte: Une nuk do të harrohem se kam lenë vepra, që do ti rezistojnë kohës. Dhe kishte të drejte. Sapo doli në pension u sëmur dhe me 23 janar 2013 ndërroi jete, duke lenë një boshllëk të madh në familje dhe në të gjithë dashamirësit e humorit.

Kane kaluar 10 vite nga kjo humbje, por figura e tij rritet dhe vërtete nuk do të harrohet kurrë!

**Donika Selimi**



# Zv. Ministri i Punëve të Jashtme, Mëhill Marku

## Kush është Mëhill Marku?

Mëhill Marku ka lindur me 5 dhjetor 1964, në fshatin Xhan të krahinës së Pulitit.

Mëhilli ishte fëmija i shtate i Nikë dhe Pashke Markut

Familja Marku, në vitin 1970 familja shpërngulet nga fshati Xhan dhe vendoset në fshatin Rrile të rrethit të Lezhës, në kërkim të një jete më të mirë ekonomike. Por zhgënjimi dhe mjerimi e ndjekin familjen për disa vite mbas vendosjes në fshatin Rrile se, mundësit e pakta ekonomike rendojnë edhe më shumë, për shkak të mospranimit të të shpërngulurve prej zyrtarëve lokal të partisë, por megjithatë mbijetoje.

Mëhilli mbaron shkollën 8-vjeçare në vitin 1979, në fshatin Rrile. Në vitin 1979 pranohet në Shkollën e mesme të Gjuhëve të Huaja në Tiranë, dega Anglisht.

Në vitin 1983 vijon studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja - dega Anglisht dhe përfundon studimet me rezultate të shkëlqyera.

Me mbarimin e universitetit, në vitin 1987 emërohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Po atë vit fillon një program një vjeçar për diplomaci, të organizuar nga Universiteti i Tiranës dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Në përfundim të këtij programi, në vitin 1988, fiton çertifikatë në Diplomacinë Ndërkombëtare.

Mëhilli, në fund të vitit 1988, fillon punë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, fillimisht në shërbimin konsullor dhe më pas në drejtorinë e shtypit.

Pas një periudhe të shkurtër, kalon në Drejtorinë e Organizatave Ndërkombëtare dhe Bashkëpunimit Shumëpalësh, në cilin fokusohet në njohën e proceseve të integritetit dhe bashkëpunimit Evropian, në procesi i Helsinkit, Konferenca për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (KSBE), Komuniteti Evropian, Këshilli i Evropës, e të tjera.

Në vitin 1991, në moshën 27 vjeçare, emërohet në detyrën e Zëvendës Ministër i Punëve të Jashtme nga Partia Demokratike në Pushtet. Në këtë funksion, bën përpjekjet e para për hapjen e Shqipërisë ndaj Evropës; viziton institucione të ndryshme evropiane, në të cilat prezanton platformën e re të qeverisë shqiptare dhe kërkon ndihmën e institucioneve evropiane për avancimin e kësaj platforme; siguron mbështetjen e parë politike dhe teknike të Evropës për reformat në Shqipëri.

Nen drejtimin e Mëhillit, delegacioni shqiptar dha kontribut të veçantë në formulimin e dokumenteve përfundimtar që çuan në pranimin e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit e Bashkëpunimit Evropën-KSBE, në vitin 1991, në Berlin.

I çmueshëm është roli i Mëhillit i luajtur për njohjen dhe përkrahjen e çështjes së Kosovës pranë qeverive dhe institucioneve evropiane. Shkëputja diplomatike dhe politike e Kosovës nga Serbia dhe trajtimi i saj si entitet i pavarur në diskutet diplomatike i dedikohet pjesërisht edhe përpjekjeve diplomatike në Helsinki, Bruksel, Prage, e të tjera, të delegacioneve diplomatike shqiptare të drejtuar prej Zv/

Ministrit të Punëve të Jashtme, Mëhill Marku. Në Maj 1992, mbas bisedimeve në Romë, arriti marrëveshjen me qeverinë Britanike për zgjidhjen e çështjes së arit

shqiptar të ngjuar në Bankën e Anglisë që në vitin 1946, çka i hapi rrugën normalizimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të Shqipërisë me Britaninë e Madhe. Të

gjitha bisedimet e mëparshme kishin dështuar.

Mëhilli në vjeshtën e vitit 1992, largohet nga Shqipëria për në Amerike.

Gjate vitit 1993, fiton disa njohuri në makro-ekonomi dhe matematike në Wayne State University në Detroit, Michigan.

Mëhilli po në këtë vit, në vitin 1993, në muajin Janar krijon familjen, me zonjën Valentina Camaj, me origjinë nga krahina e Hotit në shtetin e Malit të Zi, dhe kanë katër fëmijë, dy djem e dy vajza: Danielin, Emmen, Annen e Aleksin.

Mëhilli, në saj të punës dhe vullnetit të tij të palëkundur, në vitin 1994 pranohet në Universitetin e Princeton-it (Princeton University) në të cilin fiton Master i Administratës Publike (MPA - master of public administration) me fokus në Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Në vitin 1999 merr çertifikatë në Analize dhe Menaxhim të Riskut të Investimeve nga Instituti i Financës së New Yorkut (New York Institute of Finance)

Në vitin 2003 fiton Master në Administrimin e Busnesit (Master of Business Administration - MBA), në Universitetin e New York-ut (New York University) me fokus në Financë dhe Statistike.

Mëhilli ka punuar për kompaninë Prudential Global Investment Management - Fixed Income (PGIM FI) - fillimisht si analist në Financën Strukturuar dhe më vonë si Analyst Portofolësh (Portfolio Analyst); më pas si Menaxher Portofolësh (Portfolio Manager).

Mëhill Marku nga viti 2019, punon në detyrën e Krye-Analist i Gjeopolitikës për kompaninë PGIM: analizon zhvillimet gjeopolitike në botë dhe ndikimin që kanë për investimet globale.



Luksemburg 1992




Familja Marku, Tiranë 2017

Nga e majta në të djathtë, në këmbë-vëllezërit Marku, Vuksani, Arbeni, Lulashi e Ndoka; në mes, në të majtë motra Age Zefi e Nëna Pashka dhe ulur nga e majta në të djathtë vëllezërit: Mhilli, Viktori dhe Leka



Familja e Mhill Markut

Në këmbë nga e majta në të djathtë: Danieli, Emma, Anna dhe Aleks; ulur Mhilli e bashkëshortja Valenina Marku



Çifti Valentina e Mhill Marku, në vitin 1995 dhe në muajin nëntor 2021

Ndue Sanaj



# Profesor Doktor Vuksan Kola

Vuksan KOLA, i biri i Prekës dhe Katërinës, lindi në fshatin Lekaj të krahinës së Shalës, në Dukagjin, më 3 shkurt të vitit 1955. Pjesën më të madhe të fëmijërisë e kaloi në vendlindje. Aty mbaroi shkollën fillore me rezultate shumë të mira. Që atëherë mësuesit e tij vunë re tek ai interesim të madh për shkollën, prandaj bënë përpjekje për ta ndihmuar që të vazhdonte studimin e mëtejshëm në qytetin e Shkodrës. Arsimin 8 vjeçar e kreu në Shkollën "11 Janari", tashmë mjaft larg vendlindjes, gjatë periudhës 1967-1971, kurse të mesmen e përgjithshme e përfundoi në gjimnazin "29 Nëntori" në vitin 1975, të dyja me bursë të plotë shteti nga Konvikti "Tomë Kola". Gjatë të gjitha këtyre viteve vazhdoi të ishte një ndër nxënësit më të mirë të shkollës.

Mbas mbarimit të arsimit të mesëm, fillimisht bëri 1 vit stazh të detyrueshëm në laboratorin e H/C të Fierzës, por për shkak të disa pengesave nga Komitetit Ekzekutiv i Shkodrës për marrjen e të drejtës së studimit për në shkollën e lartë, iu desh të qëndronte atje edhe një vit tjetër. Në shtator të vitit 1977, falë rezultateve shumë të mira në mësim dhe kërkesave të tij të vijueshme, pothuajse në të gjitha nivelet e piramidës shtetërore, iu dha e drejta e vijimit të studimeve të larta në Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë, në një nga degët më të preferuara për të.

Gjatë periudhës 1977-1983 studioi me shumë pasion e këmbëngulje dhe u diplomua mjek në degën Mjekësi e Përgjithshme. Edhe këtu arriti rezultate shumë të mira, gjë që i dha mundësinë të merrte një emërim shumë të lakmueshëm për të gjithë. Ai filloi menjëherë punën në Katedrën e Neuropsikiatrisë në Tiranë, si pedagog i lëndës së Psikiatrisë, bazuar në një plenum të zgjeruar kombëtar të strukturave të larta politike e shtetërore të kohës, ku merrnin pjesë edhe përfaqësues të arsimit të lartë, i cili "i jepte të drejtë çdo fakulteti të mbante 5% të studentëve më të mirë për të zëvendësuar pedagogët e moshuar" që tashmë po i afroreshin daljes në pension. Veprimtaria e tij pedagogjik përfshin dhënien e leksioneve dhe praktikave të lëndës së Psikiatrisë së Përgjithshme studentëve të Mjekësisë së Përgjithshme, të Stomatologjisë e Farmacisë; specializantëve të psikiatrisë e të Mjekut të familjes; si edhe lëndën e Psikiatrisë ligjore studentëve të Fakultetit juridik. Tashmë ai ishte vënë përballë punëve dhe detyrimeve shumë të mëdha për të arritur synimet e tij profesionale, pedagogjike e shkencore.

Fillimisht jep disa provime pasuniversitare: Psikologji e Përgjithshme, Filozofi, Gjuhë angleze dhe Gjuhë ruse. Ndërsa gjatë periudhës 1983-1984 kryen kursin zyrtar të specializimit 1 vjeçar për mjek psikiatër, të cilin e përfundoi me vlerësim maksimal. Mbas një viti mbrojti edhe nënspecialitetin.

Me 27 korrik 1987 martohet me Prof. Dr. Ermira Kolën, nga Erseka, mbaruar studimet e larta në Mjekësi në vitin 1985, pedagoge në Fakultetin e Mjekësisë, Katedra e Pediatriës, që nga viti 1988, specializuar në Universitetin Katolik të Lëve-



nit, Belgjikë, për Terpinë Intensive gjatë periudhës 1 tetor 1994 - 30 korrik 1995, marrë titullin "Profesor" që në vitin 2015 dhe është Shefe e Shërbimit të Terapisë Intensive të Pediatriës që prej 5 vitesh.

Kanë dy vajza, Albanën dhe Edrinën, të cilat mbaruan Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë me rezultate të shkëlqyera, përkatësisht në vitet 2013 dhe 2016, dhe aktualisht kanë konvertuar diplomën në

sishëm i këtyre përpjekjeve ishte mbrojtja e gradës së parë shkencore "Kandidat i Shkencave" me 9 shkurt 1991, e cila u konvertua në "Doktor i Shkencave" në vitin 1993. Në fillim të 1990-ës zgjidhet me votim kolektiv Shefi i Klinikës Psikiatrike Nr.2 me 60 shtretër, ku u dallua për korrektësi e saktësi në trajtimin e të sëmurëve dhe në administrimin e mirë të shërbimit. Prej vitit 1991 ishte anëtar i Komisionit Epror të Përcaktimit të Aftësisë për Punë, Psikiatri-Okulistikë, për të gjithë Shqipërinë, kurse gjatë periudhës 2005-2014 kreu detyrën e kryetarit të këtij komisioni. Ai u largua nga ky post me dorëheqje personale të parevokueshme mbas 23 viteve.

Pas viteve 1990, me krijimin e mundësive më të mëdha për studime e kualifikime jashtë shtetit, kryen një specializim në Qendrën Akademike të Amsterdemit (Programi TEMPUS), më pas edhe disa të tjera afatshkurtra në Missouri (SHBA), në Birmingham (Angli), në Vienë, në Bullgari e të tjera. Ai mori pjesë në mbi 45 kongrese dhe konferenca ndërkombëtare, duke referuar në 15 prej tyre. Si rezultat i vlerësimit të veprimtarisë së tij të gjerë shkencore dhe profesionale, në vitin 2004, i jepet titulli "Profesor i Asociuar", një arritje mjaft e rrallë për kohën në fushën e psikiatrisë në Shqipëri.



Grupi i Shërbimit të Psikiatrisë, Budva, Maqedoni, 4 qershor 2005

Gjermani, ku vazhdojnë të punojnë me statusin e mjekut gjerman. Albana është e martuar dhe ka një vajzë që po i afrohet moshës 5 vjeç.

Krahas përgatitjes për arritjen e një niveli të lartë profesional dhe për perfeksionim të mësimdhënies, u mor edhe me studime shkencore, duke qëndruar vazhdimisht në kontakt me të rejtat e literaturës së fushës së psikiatrisë. Rezultat i rëndë-



Në një veprimtari ndërkombëtare, në Firenze- Itali, 3 prill 2009

Në ndihmë të koordinimit të veprimtarive profesionale, pedagogjike e shkencore midis psikiatërve shqiptarë të Shqipërisë, të Kosovës dhe Maqedonisë, së bashku me një grup kolegësh nga të tria trevat, u arrit të mbahej më 19 nëntor 2005, në Strugë të Maqedonisë, Kuvendi i Parë i Psikiatërve të këtyre tri shteteve ballkanike, i cili çoi në themelimin e "Lidhjes së Psikiatrisë Shqiptare (LPSH). Kuvendi e zgjodhi njëzëri kryetar të bordit drejtues të kësaj shoqate për mandatin e parë 3 vjeçar.

Gjatë të gjithë kohës në qendër të vëmendjes ka qenë për të puna për realizimin e synimeve shkencore, prandaj ai vazhdoi të referojë brenda e jashtë vendit dhe të botojë punimet e tij të rëndësishme. Sot në duart e studentëve, specializantëve dhe të specialistëve të ndryshëm të fushës së psikiatrisë janë 8 tekste e libra të ndryshëm të shkruar prej tij dhe 1 libër i përkthyer nga

literatura psikiatrike amerikane, të cilët evidentojnë të dhënat më të reja të literaturës psikiatrike dhe trajtimin bashkëkohor të problemeve më të rëndësishme të praktikës së punës në këtë degë të mjekësisë. I veçantë është sidomos botimi për herë të parë i "Historisë së Psikiatrisë së Shqipërisë". Publikimi dhe referimi i mbi 121 artikujve shkencorë, disa në revista të huaja, janë dëshmi e një pune të madhe shkencore dhe profesionale. Si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme në këtë drejtim, me 30 tetor 2013, plotësoi të gjitha kriteret dhe dorëzoi dosjen për të marrë titullin "Profesor". Për shkak të disa problemeve organizative të tejzgjatura të Këshillit të Profesorëve të Universitetit të Mjekësisë, titulli "Profesor", i jepet nga Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë vetëm në shkurt të vitit 2016.

Ky është bilanci i një veprimtarie aktive mbi 40 vjeçare në fushën e Psikiatrisë.

Një jetë e mbushur me veprimtari të ndryshme dhe punë të palodhur.

Profesioni psikiatër dikur shihej si i çuditshëm, gati-gati në kufirin midis magjistarit dhe mjekut, por konceptet dhe mundësitë tashmë kanë ndryshuar shumë, prandaj kjo nuk e ka penguar për të kombinuar sa më mirë punën në spital, me kërkimin shkencor, me veprimtari shoqërore dhe me organizimin sa më të përshtatshëm të kohës së lirë. Në këtë të fundit ndoshta është disi më deficitar, madje në një farë mënyre borxhli ndaj pjesëtarëve të familjes, të afërmeve, shokëve e miqve.

Në kuadrin e shfrytëzimit të kohës së lirë, në vend të parë ka vendlindjen e tij, Dukagjinin, por edhe Shkodrën, ku ka kaluar vitet më bukura të rinisë, me të cilat e lidhin njerëzit e tij, kujtimet e shumta, por edhe dëshira e përhershme për t'u kthyer atje sa herë t'i jepet mundësia.

Me 10 maj 2013 Shoqata "Atdhetarë-Dukagjini" e ka nderuar me titullin "Mirënjohja", me vendim nr. 169, me 10/5/2013, me këtë motivacion: "Promovues i përhershëm i shoqatës në realizimin e misionit të saj; vlerë intelektuale e pazëvendësueshme në gjirin e shoqatës; dimension i vërtetë i vlerave palcore dukagjinase".

Libra e artikuj të botuar dhe referate shkencore nga Prof. Dr. Vuksan Kola:

#### Libra shkencorë të botuar:

- 1-Skizofrenia, 2002.
- 2-Antipsikotikët e rinj, 2003.
- 3-Simptomat e çrregullimeve mendore, botimi I-rë, 2004; ribotim, 2008; botimi II-të dytë, 2013.
- 4-Barnat antidepressive, 2005.
- 5-Psikiatria (përkthyer nga anglishtja), 2006.
- 6-Barnat qetësuese-gjumëdhënëse dhe kundër ankthit, 2008.
- 7-Barnat stabilizuese të humorit, 2010.
- 8-Historia e Psikiatrisë së Shqipërisë, 2016.
- 9-Shenjat dhe simptomat e çrregullimeve mendore, 2017 (Shuma: 9)
- 10-Artikuj shkencorë të botuar brenda dhe jashtë vendit: 34
- 11-Botime shkencore popullore: 3
- 12- Artikuj në shtypin periodik shqiptar: 4
- 13-Shuma e botimeve: 50

Referate shkencore brenda dhe jashtë vendit: 80



# Çrregullimet antisociale të personalitetit

Çrregullimet antisociale të personalitetit, nga psikologët, mendohen çrregullime të rrezikshme. I sëmuri është shumë agresiv, një ngacim i vogël dhe, eksplodon.

Tipa të tillë i shfaqin simptomat që në fëmijërinë e hershme dhe, në moshën rinore.

Fëmijët dhunojnë kafshët dhe, bashkëmoshatarët e tyre. Kur rriten sillen brutalë dhe të pashpirt me të tjerët dhe mjedisin. Nuk i llogarisin dhe, nuk tremben nga pasojat e sjelljeve të tyre brutale. Masat ndëshkuese, për ata, nuk kanë asnjë vlerë.

Ata mendojnë të kundërtën, e heqin veten viktimë të përplasjeve me të tjerët. Në mekanizmin e ndjenjave të tyre, nuk ekziston ndjenja e fajësisë. Në jetën bashkëshortore janë shumë të vështirë, edhe të padurueshëm. Si rregull, bashkëshortësia me tipat që vuajnë nga çrregullime antisociale të personalitetit, mbaron shpejt, shpesh me dhunë dhe gjakosje.

Tipat që vuajnë nga ky çrregullim, jo vetëm që nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për veprimet brutale mbi të tjerët por, as për veten e tyre, për sjelljet antisociale që kryejnë. E kanë „portën“ e mbyllur për tek mekanizmi i ndjenjave. Ata e përjetojnë botën bardhë e zi dhe monotone. Shpesh rrezikojnë veten e tyre me aventura me makinë apo drogë.

Çrregullimet antisociale të personalitetit, janë shumë të ngjashme me psikopatën.

Psikopatët, të paktën, në shumë raste sillen mirë dhe tregohen të arsyeshëm. Megjithatë, edhe ata, manipulojnë mjedisin dhe nuk ndjejnë fajësi për keq sjelljet e tyre, njëlloj si antisocialët.

Sipas testeve të psikologëve, personat që vuajnë nga çrregullimet antisociale të personalitetit, në çdo komb janë rreth tre përqind meshkuj dhe një përqind femra. Në burgje përqindja është shumë më e lartë. Rreth 80 përqind e të burgosurve vuajnë nga kjo sëmundje. Nuk dënohen të gjithë ata që vuajnë nga çrregullime antisociale të personalitetit, prandaj edhe statistikat janë të diskutueshme.

Çrregullimet antisociale të personalitetit mendohen sëmundje dhe, si e tillë, ka simptomat e veta. Disa më tipiket janë:

Fëmijët që vjedhin, janë agresivë, gënjejnë, rebelojnë kundër prindërve dhe mësuesëve, që dhunojnë kafshët dhe bashkëmoshatarët e tyre, janë veçanërisht të rrezikuar nga kjo sëmundje. Nëse fëmija shfaq simptoma të tilla, duhet vepruar

sot, nesër është vonë.

Të rriturit me çrregullime antisociale të personalitetit, kryejnë veprime dhe sjellje të padëshiruara nga shoqëria. Ata nuk janë në gjendje që t'i vlerësojnë dhe, parandalojnë veprimet e tyre antisociale.

- Nuk kanë ndjenja për të tjerët dhe, nuk i respektojnë ndjenjat e të tjerëve.

- Tregohen vulgarë, banalë, nuk njohin moral, etikë, rregulla dhe ligje. Gënjejnë dhe shpifin për të tjerët.

- Megjithëse vendosin lidhje të shpejta me të tjerët, nuk i mbajnë gjatë, me cilindo qoftë.

e hershme. E rëndësishme është që, të bëhet dallimi nëse, çrregullimet lidhen me ndonjë sëmundje tjetër psikikë ose me dëmtim të trurit.

Psikologët mendojnë se, shkak i çrregullimeve sociale të personalitetit janë: Faktorët biologjikë dhe mjedisi. Për faktin se, kjo sëmundje shfaqet në fëmijërinë e hershme, prindit mund të bëjnë shumë, për parandalimin e saj tek fëmijët e tyre.

Sëmundja shfaqet më shumë tek binjakët njëvezorë se tek ata dyvezorë. Sipas psikologëve, kjo vërteton se, çrregullimet antisociale të personalitetit, janë të

antisociale të personalitetit, tregojnë për traumat e përjetuara në fëmijërinë e tyre. Ata nuk kanë dëgjuar gjë për vlerat morale dhe, as nuk i kanë përjetuar ato. Nuk kanë mësuar asgjë nga prindit e tyre, mbi të mirën dhe të keqen, të moralshmen dhe të pamoralshmen. Ata që kanë përjetuar dhunë psikikë dhe fizike, tregohen të pandjeshëm ndaj dhunës madje, e pëlqejnë dhe ushtrojnë atë. Fëmijët janë shumë më tepër imituese, se dëgjuese. Të gjitha veprimet antisociale të prindërve të tyre, ata i kopjojnë dhe, zbatojnë me përpikmëri. Sjellja e prindërve para fëmijëve, është shumë më e pushtetshme për edukimin e tyre se, shumica e të gjitha teorive të edukimit.

Nëse prindit nuk i vlerësojnë fëmijët e tyre për sjelljet pozitive por, vazhdimisht i ndëshkojnë për ato antisociale edhe kur janë vogëlsira, tek ata zhvillohet „programi“ i sjelljeve antisociale. Në moshën e pubertetit, shumë nga fëmijët e lënë padorë, futen në rrugën e kriminalitetit.

Psikologët mendojnë se, kuota e ulët e inteligjencës, është njëri ndër faktorët e zhvillimit të sjelljeve antisociale.

Fëmija me kuotë të ulët të inteligjencës, mbetet pas bashkëmoshatarëve të vet dhe, vuan nga ndjenja e inferioritetit. Kjo e nxitë atë për të kryer veprime aventureske, antisociale.

Sa i mundshëm është mjekimi i sëmundjes?

Psikologët dhe psikiatrit nuk janë shumë optimistë për mjekimin e saj. Më gjithë psikoterapinë dhe mjekimin me antidepressivë, në të shumtën e rasteve, terapia është e pasuksesshme. Gjithçka varet nga vetë pacienti. Nëse ai nuk e kupton se, sjelljet dhe veprimet e tij me të tjerët dhe mjedisin

janë antisociale, të gjitha përpjekjet mund të mendohen të dështuara. Deri më sot nuk është prodhuar asnjë medikament i cili, mund t'i shërojë personat me çrregullime antisociale të personalitetit. Por, kjo nuk do të thotë që, të sëmurët janë të pashpresë. Vetëm të vdekurit nuk kanë shanse, të gjallët gjithmonë kanë shanse.

**Lekë Imeraj,**  
*shkrimtar, përkthyes, publicist*



- Nuk i njohin tolerancën dhe kompromiset, janë shumë agresivë dhe të dhunshëm.

- „Kodi“ moral i tyre, në marrëdhëniet ekonomiko-sociale me të tjerët, njih vetëm dy principe: E imja është e imja, edhe e jotja është e imja dhe: Nëse unë jo, edhe ti jo.

- Nuk janë të vetëdijshëm për sjelljet dhe veprimet e tyre dhe, nuk i vlerësojnë masat ndëshkuese.

- Në të gjitha rastet hiqen viktimë dhe, fajësojnë të tjerët për gabimet e tyre.

Çrregullimet antisociale të personalitetit, zakonisht, shfaqen që në fëmijërinë

trashëgueshme.

Çrregullimet e trurit, janë gjithashtu shkak për sëmundjen. Studiuëset kanë vërtetuar se, tipat që vuajnë nga çrregullime antisociale të personalitetit, reagojnë krejt ndryshe ndaj skenave të dhunës, nga ata normalë.

Vatra e trurit, e cila quhet Inselrinde, aktivizohet në rastet e dhimbjeve dhe ndjenjave për të tjerët. Njeriu reagon normalisht, tregon respekt dhe bashkëndjenja. Nga eksperimentet e kryer me tipat antisocial, është vërtetuar se, kjo vatër, nuk aktivizohet fare.

Shumë tipa që vuajnë nga çrregullime



# Poezia e vëlla Nikolin Sh. Lëmezhit

Një recension nga: **Brikena Lazri**

Pata kënaqësinë të marr pjesë në promovimin e dy librave me poezi të vëlla Nikolin Sh. Lëmezhi, "Si Pika Vese" dhe "Kur Heshtja flet". Jemi pothuajse në të njëjtën moshë dhe jemi rritur në Blinisht të Zadrimës, duke kaluar një fëmijëri të vështirë në vitet e diktaturës dhe, pas rënies së regjimit, patëm fatin të edukohemi pranë kishës, me misionarë të jashtëzakonshëm, ku më së shumti spikat don Sciarra. Poezia e Nikolin Sh. Lëmezhit vjen e thjeshtë, e sinqertë dhe gati fëmimore, por në të njëjtën kohë me thellësi mendimi dhe pasqyrim realiteti. Botimi i parë, "Si pika Vese", na shfaq që në kopertinë, një foto të fëmijërisë bashkë me nënën, me të cilën ka pasur një marrëdhënie të veçantë si njëri prej fëmijëve më të vegjël të familjes (në fakt ai është fëmija i parafundit). Ka disa poezi që ia kushton nënës, të cilat tregojnë një grua të thjeshtë, besimtare, që mes shumë vuajtjeve që i sjell jeta, arrin të bëhet një mbështetje e fortë për familjen dhe sidomos për fëmijët e saj. Edukimin fillëtar fetar, e merr prej saj dhe që aty nis rrugëtimi i gjatë i studimeve teologjike në Shqipëri e Itali dhe përsiatjeve ku tashmë ka gjetur gëzimin e besimtarit dhe lirinë që ta jep besimi dhe për të cilën nuk ka dëshirë të bëjë asnjë kompromis. Poezia "Mbi shkopin tënd..." është mjaft e spikatur dhe shprehëse duke filluar me disa pasazhe të Biblës siç bën edhe në shumë poezi të tjera.

## Mbi Shkopin tënd...

(Kushtuar nënës Luke)

"Me gjithë shpirt duaje babën tënd dhe mos i harro ofshamet e nënës sate! Mos harro se s'do të kishe qenë pa ta, e çka do t'u japësh siç të dhanë ata?". (Siracidi 7, 29-30)

Shkopi ku ti mbështeteshe,  
tek e shoh plot mall.  
Në zemrën time prej biri,  
ç' ndjenja seç më ngjall!

Shkopi ku ti mbështeteshe,  
i shkurtër si ti vet'.  
I heshtur dhe i palëvizshëm,  
O Nënë, sa shumë më flet!

Shkopi ku ti mbështeteshe,  
është i shenjtë për mua shumë.  
Se aty, tashmë, o Nënë,  
vazhdimisht mbështetem unë.  
(Shkodër, më 07. 03. 2020)

Tek ky libër, në fakt, gjejmë poezi të mbledhura ndër vite, që nga mosha e adoleshencës e deri në ditët e sotme, duke na sjellë një panoramë të jetës në faza të ndryshme të saj. Jemi brezi që kemi përjetuar ndryshime të mëdha edhe historike të Shqipërisë, duke u gjendur në situata ndryshimesh rrënjësore, tranzicioni të vështirë, braktisje të arsimit, luftë e paktim të, një komb i copëtuar në përpjekje për t'u bashkuar, një politikë që nuk sjell progres, por bëhet pengesë, por edhe një

dëshirë dhe impenjim i madh popullor për të ecur përpara.

Poezia e Nikolin Sh. Lëmezhit, na shfaqet e përsipirtshme, ku pothuajse në asnjë varg nuk mungon referenca tek Krijuesi, por edhe tek Shkrimi i shenjtë. Në fakt, nuk jemi mësuar të shikojmë të botuara poezi me temë fetare, ndoshta sepse edhe sot pas shumë vitesh lirie besimi, akoma nuk jemi në gjendje të shpallim besimin tonë, lirinë që të jep besimi dhe frymëzimin për të shkruar për Krijuesin. Të qenit një shtet laik, nuk na pengon të jemi një popull besimtar. Po zgjedh poezinë "Sa mister i bukur" për ilustrim:

## Sa mister i bukur!

"...të dobëtit në sy të botës i zgjodhi Hyji, për t'i turpëruar të fortët". (1 Kor. 1, 27)

Sa mister i bukur,  
Ti, o Zot,  
se ëmbëlsisht  
në vogëlsira  
e në hollësira  
banon,  
më shumë  
se kudo,  
dhe bota,  
pikërisht këtë,  
nuk kupton!

Libri i dytë "Kur Heshtja flet" vjen më i sigurt dhe më prodhimtar, ku shikohet që poezia është një oazë paqeje për autorin, kur arrin të shprehë lirshëm mendimin dhe gjykimin. Të bën përshtypje fakti se në këtë libër, fjalën Heshtje e ka shkruar gjithkund me të madhe, si për të thënë vlerën më të madhe dhe shenjtërinë e kësaj teme.

Mendimi filozofik shfaqet kryesisht në poezitë e shkurtra, të cilat me 3-4 vargje japin mesazhe shumë të thella siç është:

Kur Heshtja flet  
Kur njerëzit heshtin  
dhe heshtja flet,  
aty ka Jetë...  
(Shkodër, më 12. 07. 2022)

Në këtë botë të zhurmshme, ku të gjithë flasin, thërrasin, duan të dëgjohen, të evidentohen në çdo formë e çdo mënyrë, Nikolin Sh. Lëmezhi na fton të kërkojmë heshtjen për të gjetur fillin, arsyen, kuptimin...

Gjithashtu, poezia e Nikolin Sh. Lëmezhit është edhe shumë edukuese, e perceptueshme për të gjitha moshat dhe me mesazhe morali, shprese dhe dashurie;

Barinjte dhe delet

Ka barinj,  
që në vend që të pastrojnë rrugët  
për delet e tyre,  
u shtojnë pengesa,  
dhe ka dele,  
që pa provuar kurrë kujdesin baritor,  
bëhen barinj,  
të atyre që barinj  
kurrë s'duhej të ishin,  
madje ka prej atyre,  
që të shtyrë nga Dashuria  
japin jetën për barinjte  
e nuk humbin kurrë kohë  
duke u shqetësuar  
se kujt i takon më përpara të japë jetën:  
Bariut apo deles.  
(Shkodër, më 09. 11. 2021)

Këto poezi janë vetëm një shije apo degustim dhe libri do t'ju japë me siguri efektin dehës që ka poezia.

I uroj suksese Nikolin Sh. Lëmezhit në rrugën e tij të krijimtarisë dhe them me bindje se poezia e tij ia vlen të jetë në bibliotekat tona dhe të lexohet, se kujt do t'i shijojë mjaft ëmbëlsisht dhe, e bazuar në përvojën time, mendoj se për çdo lexues, do të ndikojë pozitivisht në rritjen e nivelit shpirtëror.

Znj. **Brikena Lazri**





## \*\*\* POEZI nga NIKOLIN SH. LËMEZHI \*\*\*

**Ai më dërgoi...**

"Ai më dërgoi t'u kumtoj të vobektëve Ungjillin,  
t'u shpall robërve çlirimimin...". (Lk. 4, 18)

Sa zinxhirë  
po copëtoj,  
përgjatë  
kësaj Rruge,  
e prapë  
skllever  
duan të rrinë!  
*Shkodër, më 12. 12. 2022*

**Janë shqiptarët për ty Shqipëri!**

Shqipëri, o Nënë e shenjtë,  
n'historinë tënde të rrallë.  
Do të jem unë bir i denjë,  
do të jem një gur i gjallë.

Ti je Nënë gjithmonë me nder,  
ti je toka e larë me gjak.  
E pamposhtur je përherë,  
je shqiptonja mbi bajrak!

Ndaj gjithmonë plot dashuri  
do të këndoj në tokën mbar:  
Nëna ime, je ti, Shqipëri,  
emri yt më bën krenar.

S'do të pres nga askush tjetër,  
të vërë dorë mbi këtë ndërtesë.  
Tokë hyjnore, kaq e vjetër,  
po ta jap sot ty këtë besë.

Sa t'jen' dielli edhe hëna,  
sa të jetojë kjo njerëzi,  
sa t'ketë bij lindur nga nëna,  
janë shqiptarët për ty Shqipëri!  
*Shkodër, më 28. 02. 2023*

**Pranim**

"U bëftë vullnesa jote...". (Mt. 6, 10)  
Gjithçka  
qëndron në pranim.  
E, kur pranimi  
bëhet me gëzim,  
çdo gjë shndërrohet  
në lartësim.  
Aty, pastaj,  
ka jetë dhe liri  
në çdo drejtim.  
*Shkodër, shkurt 2023*

**Boshllëqet**

Boshllëqet  
vetëm Heshtja  
mund t'i mbushë.  
*Shkodër, më 05. 03. 2023*

**Lajmi më i Mirë**

Jam njeriu më i lumtur në botë,  
sepse jam biri i Atit Qiellor.  
Asnjë fije floku s'do t'më bjerë prej kresë,  
të njoha Ty, o Atë, dhe Ti më mjafton.

Oh, sa e bukur jeta me gjithë këtë bekim,  
tashmë të kam Ty në çdo të vështirë!  
Seç ma ndërrova pikëllimin në gëzim,  
o Atë Qiellor, babai im i mirë!

Çështë gjithë kjo paqe, gjithë kjo mirësi?  
Një thirrje në zemër vazhdimisht jehon:  
Është Lajmi i Mirë, plot me dashuri,  
që Emrin e Atit çdo ditë na e zbulon.  
*Lorient (Francë), më 06. 10. 2022*

**Mëkati dhe Jezusi...**

Jeta është e shkurtër,  
vdekja nuk vonon!  
Mëkati është shkaku,  
por Krishti e shëron!  
*Shkodër, më 11. 03. 2023*

**Të ndryshëm... e të bashkuar**

Seç ëndërrova një natë,  
burra e gra,  
të vjetër dhe fëmijë së bashku  
me ngjyra të ndryshme  
nën të vetmin diell!

Seç ëndërrova luftërat,  
dhimbjet dhe urinë  
bashkë me vuajtjet  
e breznive të së kaluarës  
që më nuk është!

Seç ëndërrova një natë,  
se sa bukur do të ishte  
të bashkonim ngjyrat  
e të shikonim këtë njerëzim  
si një lëndinë të lulëzuar!

Papritmas një zë më zgjoi,  
duke më pëshpëritur ëmbëlsisht:  
Të ndryshëm në ngjyrë  
është ajo që na bashkon  
dhe ylber na bën.  
*Marino (Romë), më 14. 10. 2004*

**Emri ytë, o Atë!**

(Kushtuar Atit Qiellor)  
Atë!  
Ti je Emri më i bukur  
në këtë jetë  
e në Përjetësi!

Atë!  
Je Emri më i bukur i Dashurisë  
që jetës i jep Jetë  
e mund të quhesh edhe Nënë!

Atë!  
Ti je Emri  
që çdo krijese  
i ke dhënë një emër!

O Atë i mirë!  
Në Emrin tënd  
gjej vetveten  
dhe gjithçka që më kishte humbur!

O Atë, Babai im i dashur!  
Unë, biri yt endacak,  
zbulova Emrin tënd,  
ndaj jam kaq i lumtur!

Mrekullisht, gjithçka më flet për Ty,  
e më josh, pa shumë shpjegime,  
drejt thellësive të tua të pafund:  
E jam gjithmonë i lumtur!  
*Blinisht, më 09. 05. 2023*

**Ati na dha gjithçka...**

"Vërtet, Hyji aq fort e deshi botën  
saqë e dha një të vetmin Birin e vet...". (Gjn. 3, 16).  
Ati  
na ka dhënë  
gjithçka  
që kishte,  
që ne të jemi  
plotësisht  
të lumtur!  
*Shkodër, më 21. 06. 2023*

**Mundësori i botimit të gazetës "Dukagjini", nr. 236**

Bar-Restorant "Orlando", me pronar z. Tome Arra, është prej shumë vitesh mundësori aktiv i gazetës "Dukagjini" dhe veprimtarive kulturore artistike të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Ambientet e këtij kompleksi janë nder më të frekuentuarat nga banoret e Dukagjinit dhe të Shkodrës, për dasma dhe veprimtari familjare. Kultura e komunikimit, cilësia e shërbimit dhe mikpritja e pronarit bëjnë diferencën e Bar-Restorant "Or-

lando" krahasuar me të tjerët. Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ka zhvilluar në këto ambiente disa veprimtari ndër vite, për bujarinë mikpritjen dhe bashkëpunimin e gjate zoti Tome Arra, është nderuar me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini". Gazeta jonë, me nr. 236 të saj përsëri është mundësuar nga ky biznesmen i suksesshëm Dukagjinin.

Faleminderit dhe respekt për punën dhe mbështetjen tuaj, me djem Dukagji-

nas si ju, Shoqata jonë ndihet më e fuqishme, Dukagjini ndihet krenar në rrugën e vështirë për tu integruar në rrjedhat e

reja të historisë.

Faleminderit dhe suksese Bar-Restorant "Orlando", me pronar z. Tome Arra!

**REDAKSIA**

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.